



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CC-2022-15

**Vendosi:** Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese  
Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës  
Gjykatës Roumen Nenkov  
Gjykatëse Romina Inkuti

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 13 qershor 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Titulli i lëndës:** Kërkesë Referuese e Hashim Thaçit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të Drejtat Themelore për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme të Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsyetuar

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën Referuese të Hashim Thaçit në lidhje me të Drejtën për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme të Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsyetuar**

---

**Parashtruesit**

Hashim Thaçi

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

## Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

E përbërë nga

Vidar Stensland, kryegjykatës  
Roumen Nenkov, gjykatës  
Romina Inkuti, gjykatëse

pas diskutimit pa prani fizike, jep vendimin e mëposhtëm

### I. PROCEDURA

#### A. KËRKESA REFERUESE

1. Më 28 shkurt 2022, z. Hashim Thaçi ("parashtruesi") i dorëzoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma")<sup>1</sup> një kërkesë referuese që mbante datën 28 shkurt 2022 ("Kërkesa Referuese"),<sup>2</sup> në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe nenit 49(3) të Ligjit. Parashtruesi përfaqësohej nga z. Gregori U. Kihou.

2. Në kërkesën e tij referuese, parashtruesi paraqiti ankesë për shkelje të drejtave themelore të tij në procesin penal që po zhvillohet kundër tij në Dhomat e Specializuara ("DHS"). Konkretisht, ai parashtrroi se ishin shkelur të drejtat e tij themelore të përcaktuara në nenin 31(2) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa"). Ai argumentoi se DHS-ja nuk kishte juridiksion për gjykim në lidhje me akuzat e ngritura kundër tij, dhe se kur ai kishte ngritur kundërshtime ndaj juridiksionit të DHS-së para Panelit të Gjykatës së Apelit,

---

<sup>1</sup> Në lidhje me caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), shih KSC-CC-2022-15, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 1 mars 2022.

<sup>2</sup> KSC-CC-2022-15, F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Thaçi për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme të Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsytuar, publike, 28 shkurt 2022 ("Kërkesa Referuese").

ky i fundit nuk e kishte trajtuar argumentin e tij të rëndësishëm në lidhje me këtë aspekt, dhe se Paneli i Gjykatës së Apelit ishte krijuar në kundërshtim me Ligjin.<sup>3</sup>

#### B. PARASHTRIMET ME SHKRIM

3. Më 30 mars dhe 8 prill 2022, ZPS-ja dhe parashtruesi dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim lidhur me Kërkesën Referuese,<sup>4</sup> ku trajtonin pyetjet që u ishin drejtuar nga Dhoma sipas rregullës 15(2) të Rregullores së Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e DHSGJK-së").<sup>5</sup>

#### C. SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE

4. Dhoma do ta shqyrtojë Kërkesën Referuese duke u bazuar në vetë Kërkesën Referuese dhe në parashtrimet e lartpërmendura me shkrim të ZPS-së dhe të parashtruesit. Dhoma do t'u referohet fakteve të çështjes dhe argumenteve të ZPS-së dhe të parashtruesit, për aq sa kanë lidhje me këtë shqyrtim të Kërkesës Referuese prej Dhomës.

## II. FAKTET

#### A. RAPORTI I KËSHILLIT TË EVROPËS

5. Më 7 janar 2011, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi një raport që përmbante pretendime për trajtim çnjerëzor dhe vrasje të personave gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë ("Raporti").<sup>6</sup>

---

<sup>3</sup> Kërkesa Referuese, para. 4-8, 26-27, 33-47, 49-50, 58-64, shih KSC-CC-2022-15, F00004, Vendim për Parashtrime të Mëtejshme, publik, 15 mars 2022, para. 3-5.

<sup>4</sup> KSC-CC-2022-15/F00004, F00005, Version i Korrigjuar i Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Vendimit për Parashtrime të Mëtejshme në lidhje me Kërkesën Referuese të Thaçit, publik, 30 mars 2022, me Shtojcën 1, publike ("Parashtrimet e ZPS-së"). KSC-CC-2022-15, F00009, Parashtrime me Shkrim të Thaçit sipas Vendimit për Parashtrime të Mëtejshme të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 8 prill 2022 ("Parashtrimet e Parashtruesit").

<sup>5</sup> KSC-CC-2022-15, F00004, Vendim për Parashtrime të Mëtejshme, publik, 15 mars 2022.

<sup>6</sup> Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Raporti Dok. 12462, Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë, 7 janar 2011.

6. Raporti u hartua në vazhdën e zbulimeve që përmbante libri me kujtime i ish-kryeprokurores së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe që kryesisht kishin të bënin me pretendimet për trafikim të organeve njerëzore në territorin e Shqipërisë.<sup>7</sup> Në të njëjtën kohë, hetimi hodhi dritë mbi pretendime të tjera të lidhura me to dhe krijoi një tablo shumë të zymtë dhe shqetësuese për atë çka kishte ndodhur në Kosovë.<sup>8</sup>

7. Në veçanti, në konstatimet e Raportit thuhej se ishin bërë pak ose aspak hetime të hollësishme të krimit të organizuar ose të krimeve të luftës të kryera kundër serbëve dhe shqiptarëve kosovarë, të konsideruar bashkëpunëtorë apo kundërshtarë të fraksioneve dominuese.<sup>9</sup> Ndërsa hetimi, në pjesën më të madhe të tij, u përqendrua në periudhën nga vera e vitit 1999 e në vazhdim, në kuadër të tij u ngritën pretendime edhe për krime që kishin ndodhur në periudhën ndërmjet viteve 1998 dhe 2000.<sup>10</sup>

8. Bazuar në Raportin e lartpërmendur, në shtator 2011, u krijua Task Forca Hetimore Speciale ("TFHS"), për kryerjen e një hetimi të pavarur penal në lidhje me pretendimet që përmbante Raporti.<sup>11</sup>

## B. SHKËMBIMI I LETRAVE I VITIT 2014

9. Më 14 prill 2014, Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendëspresidentja e Komisionit

---

<sup>7</sup> Raporti, A. Projektrezoluta, para. 3-8, 12, 17, 19; Raporti, B. Memorandumi shpjegues, para. 9, 14-19, 26, 93-167.

<sup>8</sup> Raporti, B. Memorandumi shpjegues, para. 19, 175. Shih gjithashtu Raportin, A. Projektrezoluta, para. 1-6, 10-13, 16-17, 19; Raporti, B. Memorandumi shpjegues, para. 1, 3-9, 12-15, 20-21, 26-35, 68-74, 84-92, 109, 123-124, 126-127, 129-132, 137, 144, 150, 168-176.

<sup>9</sup> Raporti, A. Projektrezoluta, para. 11.

<sup>10</sup> Raporti, A. Projektrezoluta, para. 5, 10, 17; Raporti, B. Memorandumi shpjegues, para. 4, 13, 21, 44-48, 55-61, 72-74, 87-90, 130, 144.

<sup>11</sup> Autoriteti ligjor i TFHS-së buronte nga Vendimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i 4 shkurtit 2008, mbi bazën e të cilit u themelua misioni EULEX Kosova. Shih Vendimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të 4 shkurtit 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX Kosova.

Evropian (“Përfaqësuesja e Lartë”) shkëmbyen letra. Në letrën e saj, drejtuar Përfaqësueses së Lartë, Presidentja e Kosovës deklaroi si vijon:

[...]

Nëse hetimi nga TFHS-ja rezulton me aktakuzë dhe procedura gjyqësore, duhet siguruar një mjedis i përshtatshëm për administrimin e duhur të drejtësisë. Në pajtim me këtë, një gjykatë e specializuar brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, si dhe një zyrë e specializuar prokurorie do të shfrytëzoheshin për procedurat gjyqësore dhe të apelit që dalin nga hetimet e TFHS-së. [...]

[...]

Këto struktura do të administrohen me statutin e vet [...] Kosova merr përsipër të miratojë legjislacionin përkatës për të mundësuar themelimin dhe funksionimin e dhomave të dedikuara gjyqësore në pajtim me kushtet e lartpërmendura. [...] Të gjitha masat ligjore që ndërmerren në Kosovë për themelimin e gjykatës së specializuar [...] dhe zyrës së prokurorisë së specializuar në lidhje me TFHS-në [...] do të miratohen në pajtim me ligjin në Kosovë, si dhe do t’i nënshtrohen shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.

[...]

10. Në letrën e saj drejtuar Presidentes së Kosovës, Përfaqësuesja e Lartë, deklaroi si vijon:

[...]

[...] puna e [TFHS-së] dhe çfarëdo procedurash gjyqësore që burojnë nga ajo, do të vazhdojnë deri sa Këshilli i Bashkimit Evropian ta njoftojë Kosovën që hetimet dhe procedurat përkatëse janë përmbyllur.

[...]

11. Më 23 prill 2014, me Ligjin nr. 04/L-274, Kuvendi i Kosovës ratifikoi shkëmbimin e letrave të lartpërmendur si marrëveshje ndërkombëtare mes Kosovës dhe BE-së.<sup>12</sup>

---

<sup>12</sup> Ligji nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

## C. AMENDAMENTI KUSHTETUES

12. Më 7 mars 2015, Qeveria e Kosovës propozoi një amendament në Kushtetutë, përkatësisht që pas nenit 161 të Kushtetutës të shtohet neni i ri 162 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

13. Në pjesën përkatëse të nenit 162(1), thuhet se “për [t’i] përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me [Raportin], Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të Specializuara dhe një Zyrë të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. [...] Juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë”.

## D. VLERËSIMI I KUSHTETUTSHMËRISË SË AMENDAMENTIT

14. Më 14 prill 2015, Gjykata Kushtetuese konfirmoi amendamentin kushtetues.<sup>13</sup> Në vlerësimin e saj, Gjykata Kushtetuese së pari rikujtoi se amendamenti buronte nga shkëmbimi i letrave i vitit 2014 ndërmjet Kosovës dhe BE-së,<sup>14</sup> dhe se themelimi i DHS-së dhe ZPS-së ishte një kërkesë për Kosovën që ajo të përmbushte obligimet e saj ndërkombëtare që buronin nga Raporti.<sup>15</sup>

15. Gjykata Kushtetuese më pas vlerësoi se neni 103(7) i Kushtetutës parashihte mundësinë e krijimit të gjykatave të specializuara. Për sa i përket aspektit të juridiksionit të DHS-së në veçanti, Gjykata vlerësoi se sipas nenit 103(7), “gjykata e specializuar” ishte një gjykatë me fushëveprim të specifikuar të juridiksionit.<sup>16</sup> Gjithashtu, sipas nenit 103(7) të Kushtetutës, Kosova mund të themelojë gjykata të specializuara kur kjo është “e nevojshme”.<sup>17</sup> Gjykata konstatoi se fushëveprimi i

---

<sup>13</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Referuar më 9 Mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me Shkresën nr. 05-433/DO-318*, KO 26/15, Aktvendim, 14 prill 2015 (15 prill 2015).

<sup>14</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KO 26/15, para. 37.

<sup>15</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KO 26/15, para. 39, shih gjithashtu para. 50-51.

<sup>16</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KO 26/15, para. 43, shih gjithashtu para. 44.

<sup>17</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KO 26/15, para. 45, 50.

juridiksionit të DHS-së, siç parashihej në amendament, ishte në pajtueshmëri me kërkesën e “nevojës”, pasi obligimet ndërkombëtare të Kosovës për themelimin e DHS-së dhe ZPS-së buronin nga Raporti.<sup>18</sup>

16. Më tej, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së amendamentit, Gjykata Kushtetuese vërejti se “fushëveprimi i juridiksionit [...] të Dhomave të Specializuara [do të] rregullohet me ligje të tjera, në pajtim me Kushtetutën”.<sup>19</sup> Gjykata Kushtetuese bëri të njëjtat konstatime edhe në lidhje me propozimin për themelimin e ZPS-së.<sup>20</sup>

#### E. MIRATIMI I LIGJIT

17. Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin. Sipas nenit 1(1), me këtë Ligj “themelohet dhe rregullohet [...] juridiksioni” i DHS-së dhe ZPS-së. Neni 6 i Ligjit specifikon juridiksionin lëndor të DHS-së. Në veçanti, në paragrafin (1) të tij përcaktohet se Dhomat e Specializuara “kanë juridiksion mbi krimet [...] që kanë të bëjnë me Raportin”.

#### F. PROCESI KUNDËR PARASHTRUESIT

18. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër parashtruesit, duke e akuzuar atë dhe të akuzuarit e tjerë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, që pretendohet se u kryen së paku që prej marsit 1998 deri në shtator 1999 në Kosovë dhe në zona të Shqipërisë veriore.<sup>21</sup> Duke iu referuar nenit 6 të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se akuzat ishin brenda juridiksionit lëndor të DHS-së.<sup>22</sup>

<sup>18</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KO 26/15, para. 50-53, që i referohet Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”), *Fruni v. Slovakia*, no. 8014/07, 21 June 2011, para. 142.

<sup>19</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KO 26/15, para. 59.

<sup>20</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KO 26/15, para. 59-60, 62.

<sup>21</sup> KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, publik, 26 tetor 2020 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020) (“Vendimi i Konfirmimit”), para. 15, 39, 41-42, 127, 129.

<sup>22</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 32, 38, shih gjithashtu para. 43.



19. Pas konfirmimit të akuzave nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, më 30 tetor 2020, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar.<sup>23</sup> Më 4 nëntor 2020, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e korrigjuar dhe më 3 shtator 2021 dorëzoi versionin e korrigjuar më tej të aktakuzës së konfirmuar.<sup>24</sup>

20. Në aktakuzë, ndër të tjera, pretendohet se parashtruesi, si anëtar i një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët ("NKP"), kishte qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën, duke frikësuar, keqtrajtuar, ushtruar dhunë dhe eliminuar në mënyrë të paligjshme ata që konsideroheshin si kundërshtarë.<sup>25</sup> Në aktakuzë pretendohet se anëtarët e NKP-së kryen një sulm gjerësisht të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile të kundërshtarëve në Kosovë dhe në zona të Shqipërisë veriore, së paku që prej marsit 1998 deri në shtator 1999.<sup>26</sup>

21. Ndërkohë, më 5 nëntor 2020, parashtruesi u arrestua.<sup>27</sup> Më 4 shkurt 2021, parashtruesi dorëzoi një apel të ndërmjetëm me të cilin kundërshtoi paraburgimin e

---

<sup>23</sup> KSC-BC-2020-06, F00034/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>24</sup> KSC-BC-2020-06, F00045/RED, Version i Redaktuar Publik i 'Parashtrimit të Versioneve të Korrigjuara dhe të Redaktuara Publike të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të', parashtrimi i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00045 i datës 4 nëntor 2020, publik, 18 nëntor 2020 (originali u dorëzua më 4 nëntor 2020); KSC-BC-2020-06, F00455/RED, Versioni i Redaktuar Publik i 'Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim në pajtim me Rregullën 90(1)(b)', KSC-BC-2020-06/F00455, i datës 3 shtator 2021, publik, 8 shtator 2021, me Shtojcën 1, publike (originali u protokollua më 3 shtator 2021); KSC-BC-2020-06, F00647/RED, Parashtrim prej Prokurorisë i Versioneve me më pak Redakte të Aktakuzës dhe Përmbledhjes sipas Rregullës 86(3)(b), publik, 28 janar 2022, me Shtojcat 1-2, konfidenciale (originali u dorëzua më 17 janar 2022). Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar më tej u dorëzua më 29 prill 2022, shih KSC-BC-2020-06, F00789/A05, Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së ndryshuar, publik, 29 prill 2022.

<sup>25</sup> Aktakuza, para. 32.

<sup>26</sup> Aktakuza, para. 16.

<sup>27</sup> KSC-BC-2020-06, F00051, Njoftim i Arrestimit të Hashim Thaçi sipas Rregullës 55(4), 5 nëntor 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 20 nëntor 2020).



vet.<sup>28</sup> Po të njëjtën ditë, në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit,<sup>29</sup> Kryetarja caktoi një panel për të marrë vendim në lidhje me apelin.

#### G. KUNDËRSHTIMI I JURIDIKSIONIT TË DHS-SË PREJ PARASHTRUESIT

22. Më 12 mars 2021, parashtruesi dorëzoi një mocion paraprak, në të cilin, ndër të tjera, pretendoi se aktakuza ishte jashtë juridiksionit lëndor të DHS-së.<sup>30</sup> Ai argumentoi se amendamenti kushtetues nuk mbështeste një qasje të tillë të gjerë të hetimit si ajo e zbatuar nga TFHS-ja, dhe në vend të saj e lidhte juridiksionin e DHS-së me pretendimet shumë më të ngushta të Raportit.<sup>31</sup> Në lidhje me këtë, parashtruesi argumentoi se raporti e përshkruante kuadrin e veprimtarisë së pretenduar kriminale si “krim i organizuar”.<sup>32</sup> Sidoqoftë, aktakuza nuk i referohej krimit të organizuar në Kosovë apo diku tjetër.<sup>33</sup> Në këtë këndvështrim, parashtruesi argumentoi se, duke mos trajtuar pretendimet kryesore të Raportit, akuzat kundër tij ishin dukshëm jashtë juridiksionit të DHS-së.<sup>34</sup>

23. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rrëzoi mocionin paraprak të parashtruesit lidhur me argumentimin se akuzat në Aktakuzë, në tërësi apo pjesërisht, nuk lidheshin me pretendimet që burojnë nga raporti.<sup>35</sup> Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerësoi se neni 162(1) i Kushtetutës parashihte

---

<sup>28</sup> KSC-BC-2020-06, IA004/F0001/RED, Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes së Thaçit kundër “Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm”, publik, 4 shkurt 2021, me Shtojcat 1-2, publike. Shih KSC-BC-2020-06, F00177/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm, publik, 26 janar 2021 (originali u dorëzua më 22 janar 2021).

<sup>29</sup> KSC-BC-2020-06, IA004, F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, publik, 4 shkurt 2021 (“Vendimi për Caktimin e Panelit të Apelit”). Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F0005, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, publik, 30 prill 2021.

<sup>30</sup> KSC-BC-2020-06, F00216, Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit, publik, 12 mars 2021 (“Mocioni Paraprak”), para. 28-43.

<sup>31</sup> Mocioni Paraprak, para. 24.

<sup>32</sup> Mocioni Paraprak, para. 40.

<sup>33</sup> Mocioni Paraprak, para. 40-41.

<sup>34</sup> Mocioni Paraprak, para. 43.

<sup>35</sup> KSC-BC-2020-06, F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 22 korrik 2021 (“Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake”), para. 142.

themelimin e Dhomave të Specializuara “në lidhje me” Raportin.<sup>36</sup> Në mënyrë të ngjashme, neni 6(1) i Ligjit përcakton juridiksionin lëndor të DHS-së për krimet që “kanë të bëjnë me” Raportin.<sup>37</sup> Kuptimi i thjeshtë i formulimeve “në lidhje me” dhe që “kanë të bëjnë me” në këto dispozita kërkon ekzistencën e lidhjes së mjaftueshme midis akuzave të ngritura kundër parashtruesit dhe Raportit.<sup>38</sup>

24. Gjykatësi i Procedurës Paraprake arriti në përfundimin se kjo mbështetej gjithashtu nga fushëveprimi i juridiksionit i paraparë me Ligj, i cili ishte më i gjerë se përmbajtja konkrete e Raportit.<sup>39</sup> Faktorët relevantë për përcaktimin e lidhjes janë viktimat, vendndodhjet, afati kohor, *modus operandi*, lloji i sjelljes, synimi i sjelljes, përmbajtja e sjelljes dhe Raporti.<sup>40</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se vendimi i konfirmimit të aktakuzës demonstronte se akuzat ishin të lidhura me Raportin në një masë të mjaftueshme.<sup>41</sup>

25. Më 27 gusht 2021, parashtruesi e apeloj vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>42</sup> Së pari, parashtruesi iu referua konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 14-16 më lart).<sup>43</sup> Ai parashtrroi se Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se nevoja për themelimin e DHS-së, e cila përcaktoi natyrën e saj si institucion i specializuar në përputhje me Kushtetutën, bazohej në detyrimet ndërkombëtare të Kosovës.<sup>44</sup> Këto detyrime, nga ana tjetër, buronin nga Raporti i cili përshkruante krimet shumë specifike të trajtimit mizor dhe trafikimit të organeve.<sup>45</sup>

---

<sup>36</sup> Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 110-111.

<sup>37</sup> Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 111.

<sup>38</sup> Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 108.

<sup>39</sup> Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 109-110.

<sup>40</sup> Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 107-108, 111, 139, 141.

<sup>41</sup> Vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 141.

<sup>42</sup> KSC-BC-2020-06, IA009, F00012, Apel i Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, publik, 27 gusht 2021 (“Apeli”).

<sup>43</sup> Apeli, para. 14-17, që i referohet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, KO 26/15, të cituar më lart, para. 50-54.

<sup>44</sup> Apeli, para. 14-15.

<sup>45</sup> Apeli, para.14-17, që i referohet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, KO 26/15, të cituar më lart, para. 50-54.

Përfundimi i arritur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake se DHS-ja nuk ishte themeluar për të gjykuar specifikisht vetëm këto krime e bënte atë një gjykatë me juridiksion të përgjithshëm dhe, për rrjedhojë, një gjykatë të jashtëzakonshme të ndaluar me nenin 103(7) i Kushtetutës.<sup>46</sup>

26. Së dyti, parashtruesi argumentoi se, sipas nenit 1(2) të Ligjit, DHS-ja kishte juridiksion mbi krimet e përmendura në Raport dhe që ishin hetuar nga TFHS-ja.<sup>47</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake e kishte zgjeruar fushëveprimin e juridiksionit përtej këtyre kufijve.<sup>48</sup> Gjithashtu, parashtruesi argumentoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte përzgjedhur pjesë të Raportit për të treguar gjoja se në të bëhej fjalë për krime ndërkombëtare gjatë konfliktit në Kosovë dhe jo thjesht për pretendime për trafikim organesh pas luftës dhe trajtim çnjerëzor të ndaluarve në Shqipëri.<sup>49</sup>

27. Më 30 gusht 2021, Kryetarja, në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit, caktoi një panel për të marrë vendim në lidhje me apelin e parashtruesit.<sup>50</sup>

28. Më 23 dhjetor 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelin e parashtruesit.<sup>51</sup> Për sa i përket rëndësisë së Raportit, Paneli i Apelit iu referua formulimit të nenit 162(1) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Ligjit (shih paragrafin 23 më lart), dhe konstatoi se thjesht "lidhja" midis akuzave dhe Raportit mjaftonte për të përmbushur kriterin e juridiksionit sipas nenit 6(1) të Ligjit.<sup>52</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi se, meqenëse akuzat duhet të kenë lidhje me Raportin, mund të lejohet një fushëveprim me i gjerë i juridiksionit se sa pretendimet konkrete të përfshira në Raport.<sup>53</sup> Paneli më

---

<sup>46</sup> Apeli, para. 22.

<sup>47</sup> Apeli, para. 24.

<sup>48</sup> Apeli, para. 24-33.

<sup>49</sup> Apeli, para. 34.

<sup>50</sup> KSC-BC-2020-06, IA009, F00015, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, publik, 30 gusht 2021.

<sup>51</sup> KSC-BC-2020-06, IA009, F00030, Vendim mbi Apelet kundër "Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara", publik, 23 dhjetor 2021 ("Vendimi i Apelit").

<sup>52</sup> Vendimi i Apelit, para. 66.

<sup>53</sup> Vendimi i Apelit, para. 66.

tej konfirmoi se, duke qenë se dispozitat mbi juridiksionin të përcaktuar në nenet 6 deri 9 të Ligjit janë më të gjera se pretendimet konkrete të Raportit, synimi i Ligjit nuk ishte të kufizonte juridiksionin brenda këtyre pretendimeve konkrete të Raportit.<sup>54</sup>

29. Gjithashtu, Paneli i Gjykatës së Apelit rikujtoi se Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se DHS-ja ishte një gjykatë e specializuar në përputhje me nenin 103(7) të Kushtetutës për shkak të juridiksionit të saj të veçantë dhe për shkak se themelimi i saj kishte qenë një kërkesë për Kosovën që ajo të përmbushte detyrimet e saj ndërkombëtare.<sup>55</sup> Paneli konstatoi se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese përqendrohej në çështjen nëse amendamenti kufizonte ndonjë të drejtë apo liri të garantuar në Kushtetutë dhe nuk përjashtonte juridiksionin mbi pretendime më të gjera se sa krimet e kryera në Shqipëri të përshkruara në hollësi në Raport.<sup>56</sup> Paneli i Apelit më tej vërejt si vijon:

[...] fakti që Dhomat e Specializuara janë krijuar si rezultat i detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës “që rrjedhin nga” Raporti nuk ua kufizon atyre juridiksionin në atë mënyrë që sugjeron Mbrojtja. Paneli rikujton se këto detyrime ndërkombëtare burojnë nga Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014 [...]. Ndonëse kanë të bëjnë me Raportin, këto detyrime janë më të gjera se thjesht detyrimi për të hetuar pretendimet që përmban ai, në kuptimin që janë të lidhura edhe me krijimin e Dhomave të Specializuara si një “kërkesë për Republikën e Kosovës” dhe me nevojën për të pasur procese penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase për krimet që kanë lidhje me Raportin.<sup>57</sup>

#### H. KUNDËRSHTIMI I PARASHTRUESIT NDAJ CAKTIMIT TË PANELIT TË APELIT

30. Ndërkohë, më 16 gusht 2021, parashtruesi, ndër të tjera, dorëzoi një kërkesë për heqjen dhe/ose vetëtërheqjen e Kryetares nga caktimi i panelit që do të merrte vendim për apelin e tij në lidhje me lirimin e përkohshëm.<sup>58</sup> Parashtruesi kërkoi heqjen dhe/ose

<sup>54</sup> Vendimi i Apelit, para. 67.

<sup>55</sup> Vendimi i Apelit, para. 68.

<sup>56</sup> Vendimi i Apelit, para. 69.

<sup>57</sup> Vendimi i Apelit, para. 70 (citimet janë hequr).

<sup>58</sup> KSC-BC-2020-06, F00434, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Vetëtërheqjen e Kryetares Ekaterina Trendafilova nga Caktimi i Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e Apelit të z. Thaçi lidhur me

vetëtërheqjen e Kryetares me pretendimin se, në caktimin e përbërjes së paneleve të ndryshme të Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e kërkesave të tij në lidhje me lirimin e përkohshëm dhe paraburgimin, ajo kishte krijuar perceptimin se ishte e anshme, pasi kishte larguar një nga gjykatësit e caktuar për të vendosur në lidhje me apelin e tij të parë të ndërmjetëm.<sup>59</sup>

31. Më 24 gusht 2021, Kryetarja e rrëzoi këtë kërkesë.<sup>60</sup> Kryetarja konstatoi se rregulla 20 e Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nuk parasheh vetëtërheqjen ose heqjen e Kryetarit në ushtrimin e rolit të tij/të saj administrativ gjyqësor, dhe, për këtë arsye, ajo vazhdonte të kishte kompetencë në këtë çështje.<sup>61</sup> Duke rrëzuar kërkesën, Kryetarja vuri në dukje se gjykatësit e emëruar në Regjistër nuk caktohen në panele të përhershme por caktohen për procese ose faza në bazë të nenit 33 të Ligjit vetëm kur nevojiten dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin”). Kryetarja vuri gjithashtu në dukje se gjykatësit nuk largohen por detyra e panelit përfundon me shqiptimin e vendimit mbi temën e caktuar *sub judice*.<sup>62</sup>

32. Parashtruesi më pas dorëzoi edhe dy kërkesa të tjera. Më 31 gusht 2021, ai kërkoi rishqyrtimin e vendimit të Kryetares.<sup>63</sup> Më 6 shtator 2021, ai kërkoi heqjen e një gjykatësi nga Paneli i Gjykatës së Apelit që do të vendoste për apelet e parashtruesit lidhur me lirimin e përkohshëm dhe juridiksionin e DHS-së, pasi ky gjykatës nuk ishte

---

Lirimin e Përkohshëm, publik, 16 gusht 2021 (“Kërkesa e Mbrojtjes për Vetëtërheqjen”), me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike.

<sup>59</sup> KSC-BC-2020-06, F00434, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Vetëtërheqjen e Kryetares Ekaterina Trendafilova nga Caktimi i Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e Apelit të z. Thaçi lidhur me Lirimin e Përkohshëm, publik, 16 gusht 2021, para. 9, 42-43, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike.

<sup>60</sup> KSC-BC-2020-06, F00440, Vendim mbi Kërkesën për Vetëtërheqje të Kryetares, publik, 24 gusht 2021 (“Vendimi mbi Vetëtërheqjen”).

<sup>61</sup> Vendimi mbi Vetëtërheqjen, para. 32.

<sup>62</sup> Vendimi mbi Vetëtërheqjen, para. 30.

<sup>63</sup> KSC-BC-2020-06, F00449, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Rishqyrtim të Vendimit të 24 Gushtit 2021 mbi Kërkesën për Vetëtërheqje të Kryetares, publik, 31 gusht 2021.

caktuar në panelin e apelit që kishte vendosur në lidhje me apelin e parë të ndërmjetëm të parashtruesit (shih paragrafin 21 më lart).<sup>64</sup> Parashtruesi kërkoi që të ricaktohej paneli fillestar i apelit që ishte caktuar më 4 shkurt 2021.<sup>65</sup>

33. Më 17 shtator 2021, Kryetarja rrëzoi kërkesat e parashtruesit.<sup>66</sup> Kryetarja theksoi se ajo e kishte caktuar panelin kompetent në përputhje me nenet 30(3) dhe 33(1)(c) të Ligjit. Kryetarja vuri në dukje se gjykatësi nuk ishte “zëvendësuar apo larguar”, por ishte caktuar në një panel të ri për të shqyrtuar një apel të ndërmjetëm në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.<sup>67</sup> Në këtë aspekt, Kryetarja vuri në dukje se funksioni i një paneli të caktuar të Gjykatës së Apelit përfundon me dhënien e vendimit gjatë një faze të veçantë të procesit.<sup>68</sup> Në lidhje me heqjen dhe ricaktimin e panelit fillestar, Kryetarja rikujtoi se ajo ishte autoriteti përgjegjës për caktimin e gjykatësve në panele në përputhje me Ligjin dhe konstatoi se parashtrimi i parashtruesit ishte i pabazë.<sup>69</sup>

### III. SHKELJET E PRETENDUARA

34. Parashtruesi paraqiti tri shkelje të pretenduara në kërkesën e tij referuese. Së pari, ai u ankua se ishte shkelur e drejta e tij themelore për t’u gjykuar nga një gjykatë “e themeluar me ligj” sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, pasi

---

<sup>64</sup> KSC-BC-2020-06, F00457, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Heqjen e Gjykatësit Emilio Gati nga Paneli i Gjykatës së Apelit që gjykon Apelet e z. Thaçi lidhur me Lirimimin e Përkohshëm dhe Juridiksionin, Anulimin e Vendimeve të Kryetares nr. KSC-BC-2020-06/IA010/F00005 dhe KSC-BC-2020-06/IA009/F00015, përkatësisht të datave 26 Gusht 2021 dhe 30 Gusht 2021, dhe për Ricaktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit të Emëruar nga Kryetarja me Vendimin KSC-BC-2020-06/IA004/F00002, të datës 4 Shkurt 2021, për të Vendosur mbi Apelet e z. Thaçi në lidhje me Lirimimin e Përkohshëm dhe Juridiksionin, publik, 6 shtator 2021 (“Kërkesa për Heqje”), me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike.

<sup>65</sup> Kërkesa për Heqje, para. 7, 45, që i referohen Vendimit për Caktimin e Panelit të Apelit.

<sup>66</sup> KSC-BC-2020-06, F00476, Vendim mbi Kërkesat për Rishqyrtim dhe Heqje të një Gjykatësi nga Paneli i Gjykatës së Apelit, publik, 17 shtator 2021 (“Vendimi i Kryetares”).

<sup>67</sup> Vendimi i Kryetares, para. 45-46.

<sup>68</sup> Vendimi i Kryetares, para. 47-51.

<sup>69</sup> Vendimi i Kryetares, para. 46, 51.



akuzat kundër tij dilnin jashtë kuadrit të Raportit dhe, për rrjedhojë, DHS-ja nuk kishte juridiksion t'i gjykonte ato.

35. Së dyti, parashtruesi u ankua se, kur kishte kundërshtuar juridiksionin e DHS-së para Panelit të Gjykatës së Apelit (shih paragrafin 25 më lart), ky i fundit nuk kishte trajtuar argumentin e tij të rëndësishëm në lidhje me natyrën e "jashtëzakonshme" të DHS-së, sipas nenit 103(7) të Kushtetutës. Sipas parashtruesit, Paneli i Apelit, për rrjedhojë, kishte shkelur të drejtën e tij themelore për një mendim të arsyetuar, sipas nenit 6(1) të Konventës.

36. Së fundi, parashtruesi u ankua se Paneli i Gjykatës së Apelit që vendosi për apelin e tij të ndërmjetëm ishte krijuar në kundërshtim me Ligjin, pasi ishte një panel i ndryshëm nga ai që kishte vendosur për apelin e tij të parë të ndërmjetëm më 4 shkurt 2021 (shih paragrafin 21 më lart). Në këtë aspekt, parashtruesi kërkoi që të respektohej e drejta e tij për një "gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj" sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.

#### IV. JURIDIKSIONI

37. Dhoma rikujton se Kërkesa Referuese u paraqit sipas nenit 113(7) të Kushtetutës. Dhoma gjithashtu vëren, në Kërkesën Referuese, parashtruesi paraqiti ankesa në lidhje me procesin gjyqësor kundër tij para DHS-së, konkretisht, në lidhje me juridiksionin e DHS-së për të gjykuar akuzat kundër tij, arsyetimin e dhënë në vendimin e kundërshtuar në lidhje me çështjen e juridiksionit të DHS-së dhe përbërjen e Panelit të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese ka të bëjë me DHS-në dhe ZPS-në, siç kërkohet në nenin 162(3) të Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Nga kjo rrjedh se Dhoma ka juridiksion për të vendosur në lidhje me Kërkesën Referuese.

#### V. ÇËSHTJA PARAPRAKE – PERCEPTIMI I ANSHMËRISË



## (a) Parashtrimet

38. Fillimisht, Dhoma vëren se parashtruesi argumentoi se, duke ftuar ZPS-në dhe parashtruesin që të paraqisnin parashtrime për aspekte konkrete në lidhje me pranueshmërinë e Kërkesës Referuese, Dhoma kishte nxjerrë në pah anshmërinë e saj lidhur me pranueshmërinë e Kërkesës Referuese.<sup>70</sup> Sipas parashtruesit, Dhoma gjithashtu kishte evidentuar linjat e argumenteve të ZPS-së për të kundërshtuar Kërkesën Referuese, duke specifikuar disa elemente të rëndësishme, si p.sh. faktin që procesi ende nuk ka përfunduar.<sup>71</sup>

39. Në këtë aspekt, parashtruesi deklaroi se, sipas nenit 35(2)(i) të Ligjit, ZPS-ja kishte “përgjegjësinë” për t’iu përgjigjur Kërkesës Referuese, dhe së pari duhej t’i përgjigjej të gjithë Kërkesës Referuese dhe jo disa pjesëve të caktuara të saj.<sup>72</sup> Një përgjegjësi e tillë për të dhënë përgjigje ishte e zbatueshme edhe në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, sipas nenit 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (“Ligji për Gjykatën Kushtetuese”).<sup>73</sup> Gjithashtu, rregulla 15(2) e Rregullores së DHSGJK-së nuk ofronte bazë ligjore për aspekte të tilla specifike si këto që përcaktoi Dhoma në lidhje me pranueshmërinë e Kërkesës Referuese.<sup>74</sup>

40. Rrjedhimisht, parashtruesi argumentoi se procedurat e zbatuara nga Dhoma kishin shkelur të drejtën e tij për një gjykatë të paanshme sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.<sup>75</sup>

---

<sup>70</sup> Parashtrime të parashtruesit, para. 2.

<sup>71</sup> Parashtrime të parashtruesit, para. 2, 4-5.

<sup>72</sup> Parashtrime të parashtruesit, para. 3.

<sup>73</sup> Parashtrime të parashtruesit, para. 3.

<sup>74</sup> Parashtrime të parashtruesit, para. 6.

<sup>75</sup> Parashtrime të parashtruesit, para. 2, 7.

## (b) Vlerësimi i Dhomës

41. Dhoma fillimisht rikujton se detyra e saj, sipas nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(1) dhe (3) të Ligjit, është të vlerësojë nëse parregullsitë për të cilat është ankuar parashtruesi kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, Dhoma nuk vendos për fajësinë e parashtruesit të kërkesës dhe as nuk funksionon si gjykatë apeli në lidhje me vendimet e marra nga panelet e tjera të DHS-së.<sup>76</sup>

42. Sidoqoftë, para se Dhoma të vlerësojë nëse është kryer shkelja e pretenduar e të drejtave themelore të parashtruesit, ajo duhet së pari, pasi të ketë verifikuar juridiksionin e saj, të përcaktojë nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme. Kjo rrjedh nga neni 113(1) i Kushtetutës, i cili parasheh se Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet “e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.<sup>77</sup> Gjithashtu, rregulla 15(1) e Rregullores së DHSGJK-së përcakton se Dhoma vendos për “pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e një referimi” të bërë në bazë të nenit 49 të Ligjit. Për rrjedhojë, pyetja nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme është faza e parë e shqyrtimit të Kërkesës Referuese nga Dhoma. Rrjedhimisht, fakti që, në këtë çështje, Dhoma kërkoi parashtrime specifike në lidhje me pranueshmërinë e Kërkesës Referuese nuk tregon ndonjë anshmëri nga ana e Dhomës, por thjesht se Dhoma është

---

<sup>76</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PML Nr. 44/2018 të Gjykatës Supreme të 10 Prillit 2018*, KI 72/18, Aktvendim për Papranueshmëri, 22 nëntor 2018 (14 dhjetor 2018), para. 40-41; *Imer Ibrahim dhe të tjerët kundër 49 Aktgjykimeve Individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*, KI 40/09, Aktgjykim, 23 qershor 2010, para. 66; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 383/2008, datë 10 Qershor 2011*, KI 140/11, Aktvendim për Papranueshmëri, 11 korrik 2012 (12 korrik 2012), para. 29.

<sup>77</sup> Shih KSC-CC-2020-08, F00020/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të [REDAKTUAR] në Vijim të Vendimit të Gjykatës të Vetëm (“Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm”), publik, 20 prill 2020, para. 37. Shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ae nr. 287/18 të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK. nr. 330/2019, të 1 gushtit 2019*, KI 195/19, Aktgjykim, 5 maj 2021 (31 maj 2021), para. 68-69; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml nr. 313/2018 të 10 dhjetorit 2018*, KI 12/19, Aktvendim për Papranueshmëri, 10 prill 2019 (3 maj 2019), para. 30-31; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml nr. 41/2017 të Gjykatës Supreme të republikës së Kosovës të 3 korrikut 2017*, KI 119/17, Aktvendim për Papranueshmëri, 3 prill 2019 (3 maj 2019), para. 35-36.

angazhuar në fazën e parë të shqyrtimit prej saj të Kërkesës Referuese dhe po ushtron përgjegjësinë e saj sipas nenit 113(1) të Kushtetutës për të vlerësuar nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme.

43. Në lidhje me shqyrtimin e pranueshmërisë së Kërkesës Referuese, Dhoma vëren se parashtruesi në thelb pretendon se ZPS-ja kishte përgjegjësinë për të kundërshtuar pranueshmërinë dhe se, duke bërë pyetje konkrete, Dhoma e kishte ndihmuar ZPS-në në ushtrimin e kësaj përgjegjësie. Në këtë aspekt, Dhoma rithekson se, në bazë të nenit 113(1) të Kushtetutës, ajo, në të gjitha rastet, duhet së pari të përcaktojë nëse një kërkesë referuese është e pranueshme apo jo. Në kryerjen e vlerësimit të saj për pranueshmërinë, Dhoma nuk kufizohet në asnjë mënyrë nga parashtrimet e ZPS-së, pasi ajo duhet të shqyrtojë pranueshmërinë sipas detyrës zyrtare.

44. Në këtë kontekst, rregulla 14 e Rregullores së DHSGJK-së parasheh që, në raste të caktuara, Dhoma mund ta rrëzojë “menjëherë” si të papranueshme një kërkesë referuese të paraqitur sipas nenit 49 të Ligjit. Nga kjo rrjedh se një kërkesë referuese mund të hidhet poshtë edhe pa kërkuar parashtrime në lidhje me të. Megjithatë, kur Dhoma vendos të kërkojë parashtrime, rregulla 15(2) e DHSGJK-së përcakton se Dhoma mund të kërkojë parashtrime shtesë, “në qoftë se e gjykon të nevojshme”. Në rrethanat aktuale, Dhoma e gjykoi të nevojshme të kërkojë parashtrime që do ta ndihmonin atë në shqyrtimin e pranueshmërisë së Kërkesës Referuese. Në fakt, parashtruesi jo vetëm që nuk u paragjykua, por atij iu dha një mundësi shtesë për të shprehur pikëpamjet e tij në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës së tij referuese dhe për t’iu përgjigjur parashtrimeve të ZPS-së më pas.

45. Në këtë aspekt, Dhoma gjithashtu vëren se neni 35(2)(i) i Ligjit i ofron ZPS-së bazën ligjore për t’iu dhënë përgjigje kërkesave të caktuara që i paraqiten Dhomës, por nuk e vë Dhomën para detyrimit për të kërkuar një përgjigje të tillë.

46. Dhoma më tej thekson se parashtruesi dukej se argumentonte se, në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, zyra përkatëse e prokurorit i përgjigjet një

kërkese referuese në tërësi dhe jo vetëm çështjeve të veçanta të ngritura në të. Në këtë aspekt, parashtruesi iu referua nenit 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese në pjesën përkatëse të cilit përcaktohet se “pala kundërshtarë ose pjesëmarrësi ka dyzet e pesë (45) ditë nga pranimi i kërkesës për të dorëzuar [...] përgjigjen ndaj kërkesës referuese”. Dhoma vëren se rregulla 15(2) e Rregullores për DHSGJK-në rregullon parashtrimet që i paraqiten Dhomës dhe se neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nuk është i zbatueshëm për të sipas nenit 3(4) të Ligjit.

47. Gjithashtu, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhje me kërkesat referuese për shkelje të pretenduara të drejtave themelore në proceset penale nuk e mbështet argumentin e parashtruesit. Në fakt, si praktikë e përgjithshme, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk ka kërkuar parashtrime nga prokuroria.<sup>78</sup> Për shembull, në çështjen nr. KI 70/21, parashtruesi u ankua, ndër të tjera, se ishte shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në këtë çështje bën të ditur se prokurorisë nuk iu kërkuar të komentonte në lidhje me kërkesën referuese.<sup>79</sup> Në mënyrë të ngjashme, në çështjet me numrat KI 31/21 dhe KI 193/19, lidhur me ankesat për gjykim të drejtë, prokurorive në fjalë nuk iu kërkuar të komentonin në lidhje me kërkesat referuese përkatëse.<sup>80</sup>

48. Dhoma gjithashtu vëren se, GJEDNJ-ja, veçanërisht në çështjet gjyqësore më komplekse, bën rregullisht pyetje konkrete për parashtruesin dhe qeverinë e paditur,

---

<sup>78</sup> Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, Pml.nr. 29/2021, të 13 prillit 2021, KI 113/21, Aktgjykim, 5 janar 2022 (20 dhjetor 2021), para. 9; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN. nr. 426/2020 të 23 qershorit 2020*, KI 142/20, Aktvendim për Papranueshmëri, 10 qershor 2021 (20 maj 2021), para. 9; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, Rev. nr. 324/2019, të 17 tetorit 2019, KI 05/20, Aktvendim për Papranueshmëri, 12 prill 2021 (29 mars 2021), para. 11.

<sup>79</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, Pml.nr. 293/2020, të 10 nëntorit 2020, KI 70/21, Aktvendim për Papranueshmëri, 2 qershor 2021 (21 qershor 2021), para. 6-13.

<sup>80</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës* PML.nr.224/2020, të 17 shtatorit 2020, KI 31/21, Aktvendim për papranueshmëri, 5 maj 2021 (21 maj 2021), para. 6-12; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme*, Pml.nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019, KI 193/19, Aktgjykim, 17 dhjetor 2020 (31 dhjetor 2020), para. 5-14.

jo vetëm në lidhje me pranueshmërinë e ankesave të paraqitura GJEDNJ-së, por edhe në lidhje me themelësinë e tyre.<sup>81</sup>

(c) Përfundim

49. Bazuar në sa më lart, Dhoma nuk mund të pranojë se, duke u bërë pyetje konkrete parashtruesit dhe ZPS-së në lidhje me pranueshmërinë e Kërkesës Referuese, ajo ka cenuar në çfarëdo mënyre procesin aktual.

## VI. PRANUESHMËRIA

### A. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 31(2) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 6(1) TË KONVENTËS PËR SHKAK TË AKUZAVE KUNDËR PARASHTRUESIT

50. Dhoma vë në dukje se parashtruesi u ankua se akuzat kundër tij dilnin jashtë kuadrit të Raportit dhe, për rrjedhojë, ishin jashtë juridiksionit të DHS-së.<sup>82</sup> Duke qenë se DHS-ja nuk ka juridiksion për gjykim në lidhje me akuzat, ishte shkelur e drejta e tij themelore për t'u gjykuar nga një gjykatë "e themeluar me ligj", sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.<sup>83</sup>

51. Në këtë aspekt, Dhoma vë në dukje se faktikisht ankesa ka të bëjë me të drejtën e parashtruesit për t'u gjykuar nga një gjykatë "e themeluar me ligj", sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.<sup>84</sup> Për sa i takon zbatimin të nenit 6(1) të Konventës, Dhoma rikujton se, në bazë të nenit 22(2) të Kushtetutës, ai zbatohet në

---

<sup>81</sup>, *Milovanović ECtHR and Jakovljević v. Serbia* (communication), no. 16489/20, 10 March 2022; *Zec v. Croatia* (communication), no. 35853/19, 2 June 2021; *Biba v. Albania* (communication), no. 24228/18, 10 May 2021.

<sup>82</sup> Kërkesa Referuese, para. 4-7.

<sup>83</sup> Kërkesa Referuese, para. 7, 21-44.

<sup>84</sup> ECtHR, *Jorgić v. Germany*, no. 74613/01, 12 July 2007, para. 65; *Richert v. Poland*, no. 54809/07, 25 October 2011, para. 41.

nivel kushtetues.<sup>85</sup>

52. Sidoqoftë, përpara se Dhoma të shqyrtojë themelësinë e ankesës së parashtruesit, ajo së pari duhet të përcaktojë nëse ajo është e pranueshme.<sup>86</sup> Për këtë arsye, Dhoma do të bëjë vlerësimin e kritereve të pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore, të cilat gjejnë zbatim në procesin aktual.

### 1. A është ankesa e parashtruesit e parakohshme

53. Dhoma rikujton se, në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(3) të Ligjit, individët janë të autorizuar t'i drejtohen Dhomës lidhur me "shkeljet e pretenduara[...] të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë [...]". Rregulla 14(f) e Rregullores përcakton se një referim është i papranueshëm në qoftë se asgjë në referim nuk krijon përshtypjen e shkeljes së një të drejte kushtetuese.

#### (a) Fushëveprimi i vlerësimit

54. Dhoma vë në dukje se parashtruesi pretendon se akuzat kundër tij ishin jashtë fushëveprimit të juridiksionit të DHS-së, duke shkelur kështu nenin 31(2) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës. Dhoma vëren se procesi penal kundër parashtruesit është në vazhdim dhe ende nuk është marrë vendimi në lidhje me akuzat në fjalë. Për këtë arsye, pyetja që shtrohet është nëse parashtruesi ka të drejtë të pretendojë se është viktimë e shkeljes së pretenduar.

---

<sup>85</sup> KSC-CC-2019-07, F00013, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit në lidhje me Procedurën e Marrjes në Pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, publik, 13 janar 2020 ("*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*"), para. 15. Sa i takon përfshirjes së Konventës dhe Protokolleve të saj në legjislacionin e Kosovës në nivel kushtetues, shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Aktgjykim*, KO 01/09, 27 janar 2010 (18 mars 2010), para. 40.

<sup>86</sup> Shih *Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm*, para. 37. Shih gjithashtu KI 12/19, të cituar më lart, para. 30; KI 195/19, të cituar më lart, para. 68; KI 119/17, të cituar më lart, para. 35.



## (b) Parashtrimet

55. Parashtruesi argumentoi se, në këtë fazë të procesit, ai mundte të pretendonte se ishte viktimë e shkeljes së pretenduar.<sup>87</sup> Ai argumentoi se ZPS-ja, në parashtrimet e saj, nuk kishte ofruar ndonjë burim konkret ligjor për të mbështetur pretendimin e saj se drejtësia e gjykimit, sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, duhet të vlerësohej në tërësi.<sup>88</sup> Duke iu referuar çështjeve gjyqësore *Dvorski kundër Kroacisë* dhe *Imbrioscia kundër Zvicrës*, parashtruesi argumentoi se neni 31(2) i Kushtetutës dhe neni 6(1) i Konventës, u zbatuan në fazat paraprake të procesit penal.<sup>89</sup> Parashtruesi iu referua edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhje me zbatimin e të drejtave për gjykim të drejtë në fazat paraprake të proceseve civile.<sup>90</sup>

56. Parashtruesi gjithashtu argumentoi se faza të tilla paraprake mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit.<sup>91</sup> Parashtruesi argumentoi se detyrimi i tij për të paraqitur një ankesë kushtetuese në lidhje me juridiksionin e DHS-së në fund të procesit penal do të ishte në vetvete një dënim.<sup>92</sup> Parashtruesi më tej argumentoi se konstatimet e Dhomës në *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit* treguan se një vendim i formës së prerë i një gjykatësi të procedurës paraprake mbi një mocion paraprak mund të jetë gjithashtu vendim i formës së prerë në procesin penal, i cili mund të apelohej para Dhomës.<sup>93</sup>

---

<sup>87</sup> Parashtrimet e parashtruesit, para. 23-28.

<sup>88</sup> Parashtrimet e parashtruesit, para. 24.

<sup>89</sup> Parashtrimet e parashtruesit, para. 25, që i referohet ECtHR, *Dvorski v. Croatia*, no. 25703/11, 20 October 2015, para. 76 dhe GJEDNJ, *Imbrioscia v. Switzerland*, no. 13972/88, 24 November 1993, para. 37.

<sup>90</sup> Parashtrimet e parashtruesit, para. 25-26, që i referohen Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev. nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit, të 11 gushtit 2017, dhe Vendimit IV. EK. C. nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 14 qershorit 2017*, KI 122/17, 18 prill 2018 (30 prill 2018), para. 127, dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e cituar aty.

<sup>91</sup> Parashtrimet e parashtruesit, para. 27.

<sup>92</sup> Parashtrimet e parashtruesit, para. 27.

<sup>93</sup> Parashtrimet e parashtruesit, para.16, që i referohet KSC-CC-2019-07, F00013, *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit në lidhje me Procedurën e Marrjes në Pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar*, 13 janar 2020 ("*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*"), para. 24.



57. ZPS-ja parashtroi se ankesa e parashtruesit lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, mund të vlerësohej vetëm pas përfundimit të procesit penal.<sup>94</sup> ZPS-ja pretendoi se, meqenëse procesi gjyqësor kundër parashtruesit nuk ka përfunduar, ankesa e tij ishte e parakohshme.<sup>95</sup> Duke iu referuar çështjes gjyqësore *Lenev kundër Bullgarisë*, ZPS-ja argumentoi se, në rast të një vendimi pafajësie ose ndërprerjes së procesit, një individ nuk mund të pretendonte të ishte viktimë e shkeljes së pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë. Kjo përfaqësonte një pasojë logjike të faktit se të drejtat për gjykim të drejtë duhet të vlerësohen në tërësinë e tyre në përfundim të procesit.<sup>96</sup>

(c) Vlerësimi i Dhomës

58. Dhoma fillimisht vë në dukje se ankesa e parashtruesit sipas së cilës akuzat kundër tij ishin jashtë juridiksionit të DHS-së, ka të bëjë me një aspekt specifik të garancive për gjykim të drejtë të përfshira në nenin 31(2) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës. Në veçanti, ajo ka të bëjë me të drejtën e parashtruesit që gjykimin e akuzave kundër tij ta bëjë një gjykatë “e themeluar me ligj”.<sup>97</sup>

59. Dhoma vëren se procesi penal kundër parashtruesit nuk ka përfunduar dhe akuzat në fjalë ende nuk janë shqyrtuar, për to ende nuk është marrë vendim nga një Trup Gjyqësor dhe, sipas rastit, nga Gjykata e Apelit dhe nga Paneli i Gjykatës Supreme, në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse. Gjatë zhvillimit të procesit penal, akuzat konkrete në fjalë do të duhet të vlerësohen nga panelet kompetente dhe, sipas rastit, atyre do të duhet t’u jepet klasifikimi ligjor në përputhje me juridiksionin e DHS-së. Për këtë arsye, në këtë fazë të procesit nuk dihet se si do të klasifikohen akuzat kundër parashtruesit dhe çfarë vendimi do të merret për to.

<sup>94</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

<sup>95</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 26, 31.

<sup>96</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 30, që i referohet ECtHR, *Lenev v. Bulgaria*, no. 41452/07, 4 December 2012, para. 158.

<sup>97</sup> GJEDNJ, *Richert v. Poland*, të cituar më lart, para. 41; *Jorgic v. Germany*, të cituar më lart, para. 64.

60. Në këtë aspekt, rezultati i procesit mund të jetë relevant për përcaktimin nëse një individ mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes së pretenduar të drejtës së tij për gjykim të drejtë sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës. Dhoma vë në dukje se, në çështjen gjyqësore *Sakhnovskiy kundër Ruisë* [GC] dhe *Oleksy kundër Polonisë*, GJEDNJ-ja konstatoi se një individ nuk mund të pretendonte të ishte viktimë e shkeljes së të drejtës së tij apo të saj për gjykim të drejtë sipas nenit 6(1) të Konventës, kur procesi ishte ndërprerë apo kur individi ishte shpallur i pafajshëm.<sup>98</sup> Ndër përjashtimet e kufizuara nga ky parim përfshihen ankesat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procesit në fjalë.<sup>99</sup> Sidoqoftë, Dhoma thekson se nuk është e nevojshme që ajo të përcaktojë se si do ta zbatonte këtë jurisprudencë të GJEDNJ-së, pasi akuzat penale kundër parashtruesit ende nuk janë shqyrtuar, në lidhje me to ende nuk është marrë vendim dhe, për rrjedhojë, rezultati i procesit penal është i panjohur.

61. Sa i përket argumentit të parashtruesit se shkeljet e të drejtave të tij për gjykim të drejtë, sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, lidhen me të gjitha fazat e procesit, Dhoma gjykon se parashtruesi argumentoi se shqyrtimi lidhur me respektimin e të drejtave të tij për gjykim të drejtë mund të bëhet për një fazë të veçantë të procesit penal. Në këtë aspekt, Dhoma vëren se jurisprudenca e GJEDNJ-së të cilës i referohet parashtruesi, në trajtimin e një shkeljeje që pretendohet se është kryer gjatë një faze të hershme të procesit penal, kishte të bënte me pyetjen nëse procesi në tërësi kishte qenë i drejtë, pas përfundimit të tij.<sup>100</sup> Në të dyja rastet, GJEDNJ-ja shqyrtoi nëse shkelja e pretenduar, e cila kishte ndodhur gjatë një faze të hershme të procesit penal, kishte ndikuar në drejtësinë e gjykimit në tërësi, pas shpalljes së fajësisë gjatë procesit penal.<sup>101</sup>

---

<sup>98</sup> GJEDNJ, *Sakhnovskiy v. Russia* [GC], no. 21272/03, 2 November 2010, para. 77; *Oleksy v. Poland*, no. 1379/06, 16 June 2009.

<sup>99</sup> GJEDNJ, *Osmanov and Husseinov v. Bulgaria* (dec.), nos 54178/00 and 59901/00, 4 September 2003.

<sup>100</sup> *Dvorski v. Croatia* [GC], cituar më lart, para. 57, 112; *Imbrioscia v. Switzerland*, cituar më lart, para. 35.

<sup>101</sup> *Dvorski v. Croatia* [GC], cituar më lart, para. 49, 55; *Imbrioscia v. Switzerland*, cituar më lart, para. 21, 23, 26.

62. Dhoma gjithashtu verën se në çështjen nr. KI 122/17, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e shqyrtoi shkeljen e pretenduar, duke vlerësuar nëse ajo kishte ndikuar në drejtësinë e gjykimit në tërësi dhe pas përfundimit të procesit civil.<sup>102</sup> Dhoma gjykon se çështja e lartpërmendur, në të cilën u trajtuan shkeljet e pretenduara që kishin ndodhur gjatë një fazë të hershme të procesit dhe të cilat u shqyrtuan pas përfundimit të procesit, nuk e ndryshon përfundimin se rezultati i procesit është ai që përcakton nëse parashtruesi mund të pretendojë të jetë viktimë sipas ankesës.

63. Dhoma vë në dukje se *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*, të cilit i referohet parashtruesi, nuk mbështet pretendimin e tij, pasi, edhe në atë rast, Dhoma konstatoi se Kërkesa Referuese e parashtruesit ishte e parakohshme dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.<sup>103</sup> Për dallim nga rrethanat aktuale, në *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*, Dhoma konstatoi se mjeti juridik të cilin mund ta përdorte individi, një i dyshuar, nuk ishte një mjet që Dhoma gjykoi se mund të merrej parasysh në atë situatë.<sup>104</sup> Për më tepër, çështja kishte të bënte me fazën hetimore dhe me situatën ku ende nuk kishte një panel të ngarkuar me shqyrtimin e saj.

64. Për sa i përket argumentit të parashtruesit në lidhje me procedurat e panevojshme që mund të dalin, parashtruesi duket se argumenton se kohëzgjatja e procesit penal shkel nenin 31(2) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës. Dhoma në këtë aspekt vë në dukje se parashtruesi ngriti pretendimin për një shkelje të qartë të nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, konkretisht të së drejtës për t'u gjykuar nga një "gjykatë e themeluar me ligj". Rrjedhimisht, parashtruesi nuk ngriti ankesën se procesi është zgjatur së tepërmi. Megjithëse për vlerësimin e ankesave në lidhje me kohëzgjatjen e procesit do të nevojiten elemente të tjera, ato nuk ndikojnë në vlerësimin e argumenteve të paraqitura në këtë ankesë lidhur me gjykatën

---

<sup>102</sup> KI 122/17, para. 176.

<sup>103</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*, para. 24-25.

<sup>104</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*, para. 28-29.

“e themeluar me ligj”, pasi ankesa në këtë moment është thjesht hipotetike.

(d) Përfundim

65. Rrjedhimisht, Dhoma nxjerr përfundimin se, duke mbajtur parasysh konstatimet e saj në lidhje me aspektin nëse parashtruesi mund të konsiderohet viktimë, ankesa, në këtë fazë të procesit, është e parakohshme. Për pasojë, ajo duhet të shpallet e papranueshme në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

66. Megjithëse Dhoma gjykon se Kërkesa Referuese duhet të rrëzohet për arsyet e lartpërmendura, ajo rikujton se, në bazë të nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së, një individ mund t'i paraqesë kërkesë referuese Dhomës pasi të ketë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara në ligj kundër shkeljes së pretenduar. Në lidhje me këtë, Dhoma thekson se, sipas nenit 47 të Ligjit, paneli i Gjykatës Supreme të DHS-së, në raste të përcaktuara konkretisht, shqyrton apele kundër vendimit të panelit të Gjykatës së Apelit dhe se neni 48(6),(7) i Ligjit përcakton se, pas daljes së një aktgjykimi të formës së prerë, panelit të Gjykatës Supreme mund t'i paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndër të tjera, në lidhje me shkelje të së drejtës penale.<sup>105</sup>

67. Rrjedhimisht, del se këto janë mjete juridike që do të duhej të shfrytëzoheshin në kontekstin e shterimit të mjeteve juridike lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.<sup>106</sup> Gjithsesi, duke mbajtur parasysh

---

<sup>105</sup> Dhoma vë në dukje parashtrimet e parashtruesit në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, shih Kërkesën Referuese, para. 7, 65; Parashtrimet e Parashtruesit, para. 9-22, që i referohen, ndër të tjera, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 50/2016, të 4 prillit 2016*, KI 102/16, 14 dhjetor 2016 (2 mars 2017), para. 38. Shih gjithashtu, Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 13-17, 20, 27-28.

<sup>106</sup> Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PML 125/14, të 8 korrikut 2014*, KI 185/14, Aktvendim për papranueshmëri, 8 korrik 2015 (28 shtator 2015), para. 11-13, 28-29; KI 119/17, i cituar më lart, para. 15-28, 37-38; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.529/06 të 15 marsit 2007, të Gjykatës Supreme të Kosovës, pp.nr. 200/07 të 5 korrikut 2007, dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.465/07 të 12*

se ankesa është e parakohshme, Dhoma gjykon se në këtë moment nuk është e nevojshme që të nxjerrë përfundim lidhur me kriterin e shterimit të mjeteve juridike.

68. Dhoma gjithashtu vë në dukje se, edhe pse ankesa duhet të rrëzohet si e parakohshme, ajo ngre një pyetje themelore në lidhje me funksionimin e DHS-së dhe konkretisht nëse juridiksioni i DHS-së i përcaktuar në Ligj kufizohet në përmbajtjen e Raportit. Duke pasur parasysh natyrën themelore të këtij aspekti për funksionimin e DHS-së, Dhoma e sheh të arsyeshme ta trajtojë atë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se ankesa është e parakohshme, Dhoma duhet të jetë e kujdesshme në këtë fazë që të mos ndërhyjë në kompetencat e paneleve të tjera të DHS-së në nxjerrjen e përfundimeve për pika juridike dhe faktike që lidhen me çështjen penale në shqyrtim prej tyre.

## 2. A ekziston perceptimi se është bërë shkelje

### (a) Fushëveprimi i vlerësimit

69. Siç theksohet më lart, Dhoma duhet së pari të rikujtojë se është detyrë e paneleve të tjera të DHS-së që të shqyrtojnë faktet dhe provat në përputhje me kompetencat përkatëse të tyre, si edhe të interpretojnë dhe zbatojnë dispozitat ligjore relevante për çështjen nën shqyrtim prej tyre.<sup>107</sup> Sikurse rrjedh nga praktika e mëparshme e Dhomës, pasi panelet kompetente të DHS-së të kenë pasur mundësi të shqyrtojnë këto aspekte,

---

*dhjetorit 2008, KI 113/10, Aktvendim për papranueshmëri, 23 maj 2011 (3 nëntor 2011), para. 20-24. Në këtë aspekt, Dhoma vë në dukje se praktika e Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës, përcakton se kriteri i shterimit të mjeteve juridike sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, në parim kërkon që një parashtues të paraqesë shkeljen përkatëse të pretenduar ose të paktën thelbin e saj, para Gjykatës Supreme në një procedurë për mbrojtjen e ligjshmërisë.*

<sup>107</sup> *Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së 16 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra ndërmjet 26 marsit dhe 12 prillit 2018, KI 96/18 dhe të tjerë, Aktvendim për papranueshmëri, 30 janar 2019 (19 shkurt 2019), para. 51; Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017, KI 37/18, Aktvendim për papranueshmëri, 30 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 39; Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PA-II-KZ-II-7/15 të 26 nëntorit 2015, KI 15/16, Aktvendim për papranueshmëri, 16 mars 2016 (5 prill 2016), para. 40; Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml-Kzz nr. 170/2014 të 19 shkurtit 2015, KI 38/15, Aktvendim për papranueshmëri, 11 shtator 2015 (2 nëntor 2015), para. 30.*

Dhoma mund të vlerësojë konstatimet e tyre për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.<sup>108</sup> Gjithashtu, dhe siç u përmend, Dhoma vë në dukje se pyetja nëse juridiksioni i DHS-së kufizohet në përmbajtjen konkrete të Raportit është kyçe dhe themelore në kornizën ligjore të DHS-së.

70. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e sheh të arsyeshme që në këtë fazë të procesit, të shqyrtojë nëse përfundimi i Panelit të Gjykatës së Apelit në lidhje me fushëveprimin e juridiksionit të DHS-së, krijon perceptimin e shkeljes së të drejtës së parashtruesit për një “gjykatë të themeluar me ligj” sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, në përputhje me rregullën 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

(b) Parashtrimet

71. Parashtruesi argumentoi se akuzat që përmban aktakuza nuk janë brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, pasi ato nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen e Raportit, duke shkelur kështu të drejtën e parashtruesit për t’u gjykuar nga një gjykatë “e themeluar me ligj”, sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.<sup>109</sup> Parashtruesi pretendoi se Paneli i Gjykatës së Apelit gaboi kur arriti në përfundimin se aktakuza, e cila përmbante pretendime të shumta për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, kishte të bënte me pretendimet konkrete të përfshira në Raport.<sup>110</sup> Parashtruesi deklaroi se kriteri i përcaktuar në nenin 6(1) të Ligjit, i cili kërkon që akuzat të kenë të bëjnë me Raportin, është kufizimi “më i ngushtë” dhe “më i rëndësishëm” i juridiksionit të DHS-së.<sup>111</sup>

72. ZPS-ja parashtrroi se interpretimi i ligjit është në kompetencën e gjykatave të

---

<sup>108</sup> *Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm*, para. 36. Shih ECtHR, *Sisojeva and Others v. Latvia* (striking out) [GC], no. 60654/00, ECHR 2007-I, para. 89. Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 37/18, cituar më lart, para. 41-43; *Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë Pkl.nr 45/12 të datës 18 qershor 2012*, KI 85/12 dhe KI 86/12, Aktvendim për papranueshmëri, 21 janar 2013 (22 janar 2013), para. 28.

<sup>109</sup> *Kërkesa Referuese*, para. 1-4, 21-44.

<sup>110</sup> *Kërkesa Referuese*, para. 32-36, 42.

<sup>111</sup> *Kërkesa Referuese*, para. 35-36, 43.



shkallëve më të ulëta dhe se, sipas nenit 49 të Ligjit, nuk është kompetencë e Dhomës të rivlerësojë vendimet e këtyre gjykatave mbi aspektet juridike ose faktike.<sup>112</sup> Sipas ZPS-së, interpretimin e ligjit, duke përfshirë inkorporimin në legjislacionin vendor të së drejtës ndërkombëtare, e bëjnë gjykatat e shkallëve më të ulëta<sup>113</sup> dhe ndërhyrja e Dhomës është me vend vetëm kur është kryer një gabim “arbitrar në mënyrë flagrante dhe të qartë”.<sup>114</sup> ZPS-ja parashtrroi se argumentet kryesore të parashtruesit në lidhje me juridiksionin lëndor nuk janë argumente *prima facie* për një shkelje kushtetuese apo të drejtave.<sup>115</sup>

(c) Vlerësimi i Dhomës

73. Dhoma rikujton se neni 31(2) i Kushtetutës dhe neni 6(1) i Konventës parashohin të drejtën e parashtruesit që akuzat penale ndaj tij të shqyrtohen nga një gjykatë “e themeluar me ligj”. Shprehja “e themeluar me ligj” në këto dispozita përfshin juridiksionin mbi parashtruesin. Rrjedhimisht, kriteri që një gjykatë duhet të ketë juridiksion, duhet të jetë në përputhje me “dispozitat ligjore” përkatëse.<sup>116</sup>

74. Rrjedhimisht, Dhoma duhet së pari të evidentojë cilat “dispozita ligjore” përcaktojnë në këtë rast juridiksionin e DHS-së në lidhje me Raportin. Në këtë aspekt, Dhoma rikujton se në radhë të parë i takon paneleve të tjera të DHS-së të interpretojnë dhe zbatojnë dispozitat ligjore (shih paragrafin 69 më lart). Në këtë kontekst, Dhoma vë në dukje se në përcaktimin e juridiksionit të DHS-së në lidhje me Raportin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit janë mbështetur në nenin 162(1) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Ligjit dhe kanë gjykuar se DHS-ja ka

---

<sup>112</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 33–40.

<sup>113</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 38, që i referohet Gjykatës Kushtetuese e Kosovës, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020*, KI 11/21, Aktvendim për papranueshmëri, 25 mars 2021 (31 maj 2021).

<sup>114</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 35, që i referohet *Vendimit në lidhje me Vendimin e Gjykatësit të Vetëm*, para. 36.

<sup>115</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 32.

<sup>116</sup> ECtHR, *Jorgic v. Germany*, cituar më lart, para. 65; *Richert v. Poland*, cituar më lart, para. 41.



juridiksion mbi akuzat që “kanë të bëjnë” me Raportin (shih paragrafët 23, 28, dhe 29 më lart).

75. Rrjedhimisht, Dhoma do të shqyrtojë dispozitat ligjore përkatëse, të zbatuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit, të cilat përcaktojnë juridiksionin e DHS-së në lidhje me Raportin. Fillimisht, Dhoma vë në dukje se neni 162(1) i Kushtetutës përcakton se Dhomat e Specializuara u themeluan për t’i përmbushur obligimet ndërkombëtare të Kosovës në lidhje me Raportin dhe, në pjesën përkatëse të tij, thuhet si vijon:

**Neni 162**  
**Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar**

[...]

1. Për t’i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me [Raportin], Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të Specializuara dhe Zyrë të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë.

[...]

76. Dhoma vë në dukje se, nga mënyra se si është interpretuar kjo dispozitë, shprehja “në lidhje me” e përfshirë në pjesën e parë të nenit 162 të Kushtetutës i referohet specifikisht detyrimeve ndërkombëtare (që rrjedhin nga Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014) dhe i lidh ato me Raportin. Rrjedhimisht, këto janë angazhime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Raportin. Dhoma gjithashtu vë në dukje se neni 162(1) i Kushtetutës thotë se “organizimi, funksionimi dhe juridiksioni” i Dhomave të Specializuara rregullohen me nenin 162(1) të Kushtetutës dhe me Ligj. Për rrjedhojë, Dhoma thekson se, në këtë aspekt, pjesa tjetër e nenit 162 të Kushtetutës nuk i referohet as juridiksionit të DHS-së dhe as Raportit. Me fjalë të tjera, neni 162 i Kushtetutës nuk përcakton parametrat e juridiksionit personal, kohor, territorial dhe lëndor të DHS-së. Juridiksioni i DHS-së përcaktohet në Ligj.

77. Në nenin 6(1) të Ligjit, i cili përcakton juridiksionin e DHS-së mbi krimet që kanë të bëjnë me Raportin, thuhet si vijon:

**Neni 6**  
**Juridiksioni lëndor**

1. Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi krimet e parapara në nenet 12-16 që kanë të bëjnë me [Raportin].

[...]

78. Dhoma gjykon se neni 162(1) i Kushtetutës dhe neni 1(1) i Ligjit përcaktojnë se Ligji shërben si një instrument i veçantë i paraparë me Kushtetutë për rregullimin e të gjitha aspekteve të funksionimit të DHS-së dhe për përmbushjen dhe zbatimin në këtë mënyrë të detyrimeve ndërkombëtare për të cilat është rënë dakord në Shkëmbimin e Letrave. Kjo përfshin, ndër të tjera, përcaktimin e kufijve të juridiksionit të DHS-së të paraparë në nenin 6(1) për vepra penale konkrete sipas të drejtës penale ndërkombëtare. Fakti që juridiksioni i DHS-së nuk kufizohet vetëm në veprat penale të përmendura në Raport, mbështetet gjithashtu nga neni 6(2) i Ligjit, sipas të cilit Dhomat e Specializuara kanë juridiksion edhe mbi vepra penale specifike të parapara në Kodin Penal të Kosovës, kur ato kanë të bëjnë me procedura zyrtare dhe zyrtarë të DHS-së.

79. Për sa i përket parësisë së Ligjit në përcaktimin e juridiksionit, Dhoma gjithashtu rikujton përfundimin e arritur nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës se fushëveprimi i juridiksionit të DHS-së, i përcaktuar në nenin 162(1) të Kushtetutës, ishte në pajtueshmëri me kërkesën e nevojës për themelimin e një gjykatë të specializuar, bazuar në detyrimet ndërkombëtare që buronin nga Raporti (shih paragrafët 14 dhe 15 më lart). Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014 përcaktoi më tej fushëveprimin e juridiksionit mbi bazën e hetimeve të kryera në lidhje me pretendimet që dolën nga Raporti (shih paragrafin 9 më lart).

80. Parashtruesi argumentoi se ishte shkelur e drejta e tij për t'u gjykuar nga një "gjykatë e themeluar me ligj", sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, , pasi akuzat kundër tij janë jashtë fushëveprimit të Raportit. Në këtë aspekt, duket se parashtruesi pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit nuk e kufizuan fushëveprimin e juridiksionit në krimet konkrete që përmbante Raporti, duke u bazuar në faktin se Raporti ishte kyç për krijimin e DHS-së. Rrjedhimisht, Dhoma do të shqyrtojë instrumentet relevante për përcaktimin e fushëveprimit të juridiksionit të DHS-së.

81. Dhoma vë në dukje se, pas Raportit, Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014 përcaktoi themelimin e një gjykate të specializuar për të gjitha proceset gjyqësore dhe të apelit, që buronin nga hetimi i TFHS-së. Gjithashtu, në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 thuhej se DHS-ja përfundimisht do të administrohej sipas statutit të vet (shih paragrafin 9 më lart). Dhoma gjithashtu vë në dukje se Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në vijim të përfundimit të nxjerrë prej saj se natyra e specializuar e DHS-së ishte në përputhje me Kushtetutën për shkak të nevojës për përmbushjen e detyrimeve të Kosovës, përcaktoi se fushëveprimi i juridiksionit të DHS-së do të rregullohej me një ligj tjetër (shih paragrafët 14 dhe 15 më lart). Formulimi i amendamentit nr. 24 të përmendur më lart, të cilin e shqyrtoi Gjykata Kushtetuese e Kosovës, përcaktonte në mënyrë të ngjashme themelimin e DHS-së, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Kosovës në lidhje me Raportin (shih paragrafin 13 më lart).

82. Në këtë aspekt, Dhoma rikujton se Paneli i Gjykatës së Apelit arriti në përfundimin se neni 162(1) i Kushtetutës dhe neni 6(1) i Ligjit, bazuar në kuptimin e zakonshëm të shprehjeve "në lidhje me" dhe "kanë të bëjnë me", përcaktojnë që akuzat duhet të kenë lidhje me Raportin, por mund të zgjerohen përtej përmbajtjes konkrete të tij. Dhoma gjykon se, duke qenë se akuzat duhet të kenë lidhje me Raportin, një lidhje e tillë duhet të kuptohet si marrje parasysh e përmbajtjes dhe kontekstit të pasqyruar në Raport dhe detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës që burojnë nga Raporti. Me fjalë të tjera, aktet e rënda të cilat do të vlerësohen duhet të

kenë lidhje me përmbajtjen dhe kontekstin e Raportit, i cili, ndër të tjera, pasqyroj një tablo të përgjithshme shqetësuese të situatës në Kosovë, duke përfshirë mungesën e llogaridhënies për disa sjellje të rënda kriminale (shih paragrafët 5-7 më lart). Ky konstatim pasqyrohet edhe me përmendjen e Raportit në nenin 1 të Ligjit, i cili përcakton *qëllimin* e Ligjit.

83. Në lidhje me këtë, Dhoma gjithashtu pajtohet me përfundimin e arritur nga Paneli i Gjykatës së Apelit se, në qoftë se hartuesit e Ligjit do të kishin synuar të kufizonin juridiksionin e DHS-së vetëm në pretendimet konkrete që përmban Raporti dhe jo në kontekstin dhe përfundimet e përgjithshme të tij, ata do ta kishin bërë këtë shprehimisht në Ligj.

84. Gjithashtu, Dhoma vë në dukje se instrumentet relevante për themelimin e DHS-së theksuan rëndësinë e krijimit të DHS-së duke pasur parasysh Raportin. Duke bërë këtë, këto instrumente nuk përcaktuan parametrat konkretë të fushëveprimit të juridiksionit të DHS-së, i cili ishte lënë të rregullohej me Ligjin që u miratua duke pasur parasysh detyrimet e Kosovës, shtysë për të cilat kishte qenë Raporti. Dhoma vë në dukje se instrumentet relevante dhe interpretimi i këtyre instrumenteve, përcaktojnë rëndësinë e Raportit për themelimin e DHS-së, pa përcaktuar parametrat konkretë të juridiksionit të DHS-së, që përcaktohet në Ligj. Rrjedhimisht, Dhoma nuk konstaton ndonjë kundërshti në përfundimin e arritur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit në lidhje me juridiksionin e DHS-së të përcaktuar në Ligj.

85. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se ankesa nuk krijon perceptimin se është kryer shkelje e të drejtës së parashtruesit, të përcaktuar në nenin 31(2) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës, për marrjen e vendimit lidhur me akuzat nga një “gjykatë e themeluar me ligj”. Rrjedhimisht, në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së, ankesa është e papranueshme.

B. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 31(2) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT  
6(1) TË KONVENTËS PËR SHKAK TË ARSYETIMIT TË PANELIT TË APELIT

(a) Fushëveprimi i vlerësimit

86. Dhoma vë në dukje se parashtruesi u ankua se Paneli i Gjykatës së Apelit nuk e trajtoi argumentin e tij se përfundimi i arritur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në lidhje me fushëveprimin e juridiksionit të DHS-së, e bëri atë një gjykatë “të jashtëzakonshme”, në shkelje të nenit 103(7) të Kushtetutës. Sipas parashtruesit, Paneli i Gjykatës së Apelit shkeli kështu të drejtën themelore të parashtruesit për një mendim të arsyetuar sipas nenit 6(1) të Konventës.

87. Dhoma vë në dukje se parashtruesi u mbështet në nenin 6(1) të Konventës. Dhoma rikujton se në bazë të nenit 22(2) të Kushtetutës, neni 6 i Konventës zbatohet në nivel kushtetues.<sup>117</sup>

88. Dhoma gjithashtu vë në dukje se parashtruesi i referohet vetëm nenit 6(1) të Konventës. Në këtë aspekt, Dhoma rikujton se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konfirmuar se e drejta për mendim të arsyetuar zbatohet edhe sipas nenit 31(2) të Kushtetutës.<sup>118</sup>

89. Duke qenë se parashtruesi u ankua se Paneli i Apelit nuk trajtoi një argument të rëndësishëm lidhur me natyrën “e jashtëzakonshme” të DHS-së sipas nenit 103(7) të Kushtetutës, Dhoma rrjedhimisht nxjerr përfundimin se kjo ankesë ka të bëjë me të drejtën e parashtruesit për mendim të arsyetuar sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe

---

<sup>117</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit*, para. 15. Siç u përmend më lart, sa i takon përfshirjes së Konventës dhe Protokolleve të saj në legjislacionin e Kosovës në nivel kushtetues, shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KO 01/09, të cituar më lart, para. 40.

<sup>118</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës në lidhje me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit*, KI 99/14 dhe KI 100/14, Vendim për masa të përkohshme, 3 korrik 2014 (8 korrik 2014), para. 86. Shih gjithashtu ECtHR, *Torija v. Spain*, no. 18390/91, 9 December 1994, para. 30.

nenit 6(1) të Konventës.<sup>119</sup>

90. Duke iu kthyer vlerësimit të ankesës, Dhoma vë në dukje se konstatimet e saj të mëhershme në lidhje me aspektin nëse parashtruesi mund të konsiderohet viktimë vlejné edhe për këtë ankesë (shih paragrafët 57-66 më lart). Sidoqoftë, Dhoma rikujton se ajo mund të vlerësojë përfundimet e një paneli të DHS-së për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, veçanërisht nëse ato janë arbitraret flagrant dhe i qartë.<sup>120</sup> Siç u përmend më lart, Dhoma rikujton se një vlerësim i tillë nuk cenon asnjë vendim të ardhshëm mbi ankesat, nëse do të ketë të tilla, që parashtruesi mund t'i parashtojë Dhomës (shih paragrafët 66-69 më lart).

91. Rrjedhimisht, Dhoma e sheh të arsyeshme që të shqyrtojë, në këtë fazë të procesit, nëse konstatimet e Panelit të Gjykatës së Apelit, ose mungesa e tyre, në lidhje me përfundimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, shkelin në dukje nenin 31(2) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës, në përputhje me rregullën 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

(b) Parashtrimet

92. Parashtruesi argumentoi se, kur ai kundërshtoi juridiksionin e DHS-së para Panelit të Gjykatës së Apelit, ai nuk trajtoi një argument të rëndësishëm të parashtruesit. Parashtruesi argumentoi se nëse juridiksioni i DHS-së nuk kufizohet në pretendimet konkrete që përmban Raporti, atëherë DHS-ja nuk është një “gjykatë e specializuar” e lejuar në bazë të nenit 103(7) të Kushtetutës, por një “gjykatë e jashtëzakonshme” e ndaluar në bazë të nenit 103(7).<sup>121</sup> Parashtruesi argumentoi se, duke mos trajtuar këtë argument, Paneli i Gjykatës së Apelit shkeli të drejtën themelore të parashtruesit për mendim të arsyetuar sipas nenit 6(1) të Konventës.<sup>122</sup>

---

<sup>119</sup> ECtHR, *Moreira Ferreira v. Portugal*, no. 2 [GC], no. 19867/12, 11 July 2017, para. 84.

<sup>120</sup> *Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatësit të Vetëm*, para. 36.

<sup>121</sup> Kërkesa Referuese, para. 59.

<sup>122</sup> Kërkesa Referuese, para. 58-64; Parashtrimet e Parashtruesit, para. 32.

93. ZPS-ja argumentoi se parashtruesi nuk ishte në gjendje të pretendojë shkelje kushtetuese, pasi vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit ishte i arsyetuar në masë të mjaftueshme, në përputhje me praktikën juridike të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të GJEDNJ-së.<sup>123</sup> ZPS-ja parashtroi se Paneli i Gjykatës së Apelit kishte bërë një përmbledhje të argumenteve të parashtruesit në lidhje me natyrën e specializuar të DHS-së dhe kishte trajtuar arsyetimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake në lidhje me këtë.<sup>124</sup>

(c) Vlerësimi i Dhomës

94. Dhoma rikujton se e drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, kërkon që gjykatat të parashtrojnë në mënyrën e duhur arsyet mbi të cilat bazohet vendimi. Ndonëse nuk kërkohet një përgjigje e detajuar për secilin argument, argumentet kryesore të parashtruesit duhet të trajtohen dhe arsyet e dhëna duhet të bazohen në dispozitat ligjore përkatëse.<sup>125</sup>

95. Në rastin konkret , parashtruesi argumentoi se Paneli i Gjykatës së Apelit nuk trajtoi argumentin e tij se nëse juridiksioni i DHS-së nuk kufizohet në pretendimet konkrete që përmban Raporti, atëherë DHS-ja nuk është një “gjykatë e specializuar” e lejuar në bazë të nenit 103(7) të Kushtetutës, por një “gjykatë e jashtëzakonshme” e ndaluar në bazë të nenit 103(7) të Kushtetutës.

---

<sup>123</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 41, që i referohet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme AML Nr. 1/2019 të 16 prillit 2019*, KI 131/19, Aktvendim për papranueshmëri, 11 mars 2020 (21 prill 2020), para. 41; Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AC nr. 3917/17, të 25 tetorit 2017*, KI 154/17 dhe KI 05/18, Aktvendim për papranueshmëri, 22 korrik 2019 (13 gusht 2019), para. 85; Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ASC -11-0012, të 22 shtator 2016*, KI 143/16, Aktvendim për papranueshmëri, 17 maj 2018 (8 qershor 2018), para. 56; ECtHR, *Merabishvili v. Georgia*, no. 72508/13, 28 November 2017, para. 227.

<sup>124</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 44, që i referohen vendimit të Gjykatës së Apelit, para. 66-73.

<sup>125</sup> *Moreira Ferreira v. Portugal (no. 2)*, cituar më lart, para. 84; Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017*, KI 146/17, Aktgjykim, (30 maj 2018 (7 qershor 2007), para. 78; KI 119/17, cituar më lart, para. 47.



96. Në këtë aspekt, Dhoma vë në dukje se Paneli i Gjykatës së Apelit trajtoi përputhshmërinë e juridiksionit të DHS-së me nenin 103(7) të Kushtetutës. Paneli iu referua përfundimit të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës se DHS-ja është në përputhje me nenin 103(7) të Kushtetutës, si për shkak të fushëveprimit të juridiksionit të saj të përcaktuar në mënyrë konkrete, ashtu edhe për shkak se themelimi i saj ishte një kërkesë për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare që buronin nga Raporti. Në këtë aspekt, Paneli i Gjykatës së Apelit vuri në dukje se fushëveprimi i vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ishte nëse DHS-ja ishte në përputhje me Kushtetutën dhe nuk u deklarua në lidhje me juridiksionin e DHS-së (shih paragrafin 29 më lart).

97. Paneli i Gjykatës së Apelit vuri në dukje se nevoja që përcaktoi natyrën e specializuar të gjykatës buronte nga detyrimet që lindën nga Raporti dhe Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014, ndër të cilat “nevoja për të siguruar procese penale të sigurt, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me Raportin”. Paneli i Gjykatës së Apelit arriti në përfundimin se fakti që DHS-ja kishte një fushëveprim më të gjerë të juridiksionit sesa përmbajtja konkrete e Raportit, ndër të tjera, për shkak të detyrimeve që çuan në themelimin e DHS-së, nuk ia hoqi DHS-së natyrën e specializuar, sipas vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe nuk e ktheu atë në një “gjykatë të jashtëzakonshme” në kundërshtim me nenin 103(7) të Kushtetutës (shih paragrafin 29 më lart).

98. Bazuar në sa më lart, Dhoma konstaton se Paneli i Gjykatës së Apelit e trajtoi argumentin e parashtruesit dhe u mbështet konkretisht në praktikën juridike të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në këtë drejtim. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se ankesa e parashtruesit se Paneli i Gjykatës së Apelit nuk dha një mendim të arsyetuar nuk krijon perceptimin e shkeljes së nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës. Rrjedhimisht, kjo ankesë duhet të shpallet e papranueshme në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

C. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 31(2) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT  
6(1) TË KONVENTËS NË CAKTIMIN E PANELIT TË APELIT

(a) Fushëveprimi i vlerësimit

99. Parashtruesi u ankua se Paneli i Gjykatës së Apelit që vendosi për apelin e tij të ndërmjetëm kundër vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi mocionin paraprak lidhur me juridiksionin e DHS-së ishte krijuar në kundërshtim me Ligjin, pasi nuk ishte i njëjti panel që kishte marrë vendimin në lidhje me apelin e tij të parë të ndërmjetëm (shih paragrafin 30 më lart).<sup>126</sup> Gjithashtu, parashtruesi u ankua, në terma të përgjithshme, se interpretimi që Kryetarja u kishte bërë dispozitave ligjore që përcaktojnë emërimet e gjykatësve në panele, kishte eliminuar garancitë institucionale që sigurojnë pavarësinë dhe paanësinë e gjykatësve të DHS-së, dhe i kishte dhënë Kryetares kompetencë për të ndikuar në marrjen e vendimeve prej tyre.<sup>127</sup> Në këtë aspekt, parashtruesi kërkoi respektimin e të drejtës së tij për një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj” sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.<sup>128</sup>

100. Duke qenë se parashtruesi u ankua se Paneli i Gjykatës së Apelit ishte krijuar në kundërshtim me Ligjin, Dhoma konstaton se kjo ka të bëjë me të drejtën e parashtruesit për t’u gjykuar nga një “gjykatë e themeluar me ligj” sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.<sup>129</sup> Në mënyrë të ngjashme, pretendimi i parashtruesit në lidhje me pavarësinë dhe paanësinë e Panelit të Gjykatës së Apelit duhet të shqyrtohet sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.

101. Në lidhje me vlerësimin e ankesës, Dhoma vë në dukje se konstatimet e saj të mëhershme në lidhje me aspektin nëse parashtruesi mund të konsiderohet viktimë,

---

<sup>126</sup> Kërkesa Referuese, para. 45.

<sup>127</sup> Kërkesa Referuese, para. 49-50.

<sup>128</sup> Kërkesa Referuese, para. 45, 50.

<sup>129</sup> Shih, mes shumë të tjerash, ECtHR, *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC], no. 26374/18, 1 December 2020, para. 212, me referenca të mëtejshme në jurisprudencë.

vlejnë edhe për këtë ankesë (shih paragrafët 58-68 më lart). Sidoqoftë, Dhoma rikujton se ajo mund të vlerësojë përfundimet e një paneli të DHS-së për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, veçanërisht në qoftë se ato janë arbitraret flagrant dhe i qartë.<sup>130</sup> Dhoma rikujton se një vlerësim i tillë nuk cenon asnjë vendim të ardhshëm mbi ankesat, nëse do të ketë të tilla, që parashtruesi mund t'i parashtrojë Dhomës (shih paragrafët 66-69 më lart).

102. Rrjedhimisht, Dhoma e sheh të arsyeshme që të shqyrtojë nëse, në këtë fazë të procesit, ankesa krijon perceptimin e shkeljes së nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

(b) Parashtrimet

103. Parashtruesi argumentoi se nenet 30(3) dhe 33(1)(c) të Ligjit përcaktojnë që gjykatësit e emëruar në një panel të Gjykatës së Apelit për një çështje konkrete shërbejnë në panelin e apelit deri në nxjerrjen e aktgjykimit mbi themelësinë në atë çështje.<sup>131</sup> Parashtruesi argumentoi se Kryetarja e interpretoi gabimisht Ligjin, sikur ai përcakton caktimin e panelit të apelit për të vendosur vetëm në lidhje me një apel të ndërmjetëm.<sup>132</sup> Sipas parashtruesit, zbatimi i gabuar i Ligjit nga Kryetarja dhe caktimi i mëpasshëm i paneleve të veçanta të apeleve, i mundësojnë Kryetares të ndikojë në Panelin e Apelit.<sup>133</sup>

104. ZPS-ja parashtroi se, duke qenë se parashtruesi kundërshtoi interpretimin që Kryetarja i bëri Ligjit, ankesa e parashtruesit lidhur me caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit nuk është në kompetencë të Dhomës.<sup>134</sup> Në veçanti, ZPS-ja parashtroi se interpretimi i Ligjit ishte në kompetencën e paneleve të tjera dhe se shmangia nga kjo rregull lejohet vetëm kur një gabim është aq i rëndë saqë ngrihet në nivelin e

---

<sup>130</sup> *Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatësit të Vetëm*, para. 36.

<sup>131</sup> Kërkesa Referuese, para. 47.

<sup>132</sup> Kërkesa Referuese, para. 49.

<sup>133</sup> Kërkesa Referuese, para. 45-47, 49-50.

<sup>134</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 33.

“arbitraritetit flagrant dhe të qartë”.<sup>135</sup> Duke qenë se parashtruesi thjesht nuk u pajtua me rezultatin e interpretimit të Ligjit nga Kryetarja, ankesa e tij rrjedhimisht është e papranueshme.<sup>136</sup>

(c) Vlerësimi i Dhomës

105. Dhoma vë në dukje se neni 31(2) i Kushtetutës dhe neni 6(1) i Konventës garantojnë gjykim të drejtë nga një “gjykatë e themeluar me ligj”<sup>137</sup> Për sa i takon termit “ligj” konkretisht në këtë frazë, Dhoma rikujton se, në jurisprudencën e saj, GJEDNJ-ja ka konstatuar se në “ligj” përfshihet jo vetëm legjislacioni që parashikon krijimin dhe kompetencat e organeve gjyqësore, por edhe çdo dispozitë tjetër e legjislacionit vendor e cila, nëse shkelet, do ta bënte të parregullt pjesëmarrjen e një apo më shumë gjykatësve në shqyrtimin e një çështjeje.<sup>138</sup> Me fjalë të tjera, shprehja “e themeluar me ligj” përfshin edhe respektimin nga gjykata të rregullave të veçanta në bazë të të cilave ajo funksionon dhe përbërjen e panelit në secilën çështje.<sup>139</sup>

106. Rrjedhimisht, për të vlerësuar nëse ekziston perceptimi se është kryer shkelje në lidhje me caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, Dhoma së pari duhet të përcaktojë dispozitat ligjore që vendosin kohëzgjatjen e caktimit. Në këtë aspekt, Dhoma vë në dukje se Kryetarja, në vendimin e saj për caktimin e panelit të kundërshtuar të apelit, i është referuar, ndër të tjera, nenit 33(1)(c) të Ligjit (shih paragrafin 27 më lart).

---

<sup>135</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 34-35.

<sup>136</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 39.

<sup>137</sup> Theksojmë se edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në çështjen nr. KI 108/19, shqyrtoi ankesën lidhur me përbërjen e panelit sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës, duke aplikuar jurisprudencën e GJEDNJ-së në përputhje me nenit 53 të Kushtetutës. Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-1-19-0016 të 28 shkurtit 2019*, KI 108/19, Aktvendim për papranueshmëri, 12 prill 2021 (7 maj 2021), para. 36, 38.

<sup>138</sup> Shih, mes të tjerash, ECtHR, *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC], cited above, para. 212; *Lavents v. Latvia*, no. 58442/00, 28 November 2002, para. 114; *Pandjikidzé and Others v. Georgia*, no. 30323/02, 27 October 2009, para. 104.

<sup>139</sup> ECtHR, *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC], cituar më lart, para. 213; *Lavents v. Latvia*, cituar më lart, para. 114; *Kontalexis v. Greece*, no. 59000/08, 31 May 2011, para. 42; *Fatullayev v. Azerbaijan*, no. 40984/07, 22 April 2010, para. 144; *Buscarini v. San Marino*, no. 31657/96, 4 May 2000.

Gjithashtu, Dhoma vë në dukje se për këtë vlerësim, me rëndësi është edhe neni 30(3) i Ligjit. Në pjesët përkatëse të këtyre dispozitave thuhet si vijon:

**Neni 30**  
**Kompetencat dhe statusi i gjyqtarëve**

[...]

3. Kur gjyqtari caktohet nga Regjistri për të marrë pjesë në ndonjë fazë të procedurës paraprake, shqyrtimit gjyqësor, gjykatës së apelit, gjykatës supreme të ndonjë rasti [...], ai gjyqtar caktohet për një mandat katërvjeçar, ose deri në përfundimin e fazës së procedurës në të cilën ai ose ajo është caktuar, në rast se ajo fazë përfundon më herët.

[...]

**Neni 33**  
**Caktimi i gjyqtarëve dhe përbërja e paneleve**

1. Kryetari i cakton gjyqtarët nga Regjistri [...] si më poshtë:

[...]

c. Paneli i Gjykatës së Apelit, sapo të paraqitet parashtrësia për ankesë të ndërmjetme në lidhje me ndonjë vendim të gjyqtarit të procedurës paraprake ose të trupit gjykues sipas të drejtës nga neni 45(1), jepet leja për ankesë të ndërmjetme sipas nenit 45(2) ose parashtrëhet njoftimi për ankesë në lidhje me ndonjë aktgjykim të trupit gjykues sipas nenit 46. Caktimet e gjyqtarëve të Panelit të Gjykatës së Apelit përfundojnë në ditën pasi Paneli i Gjykatës së Apelit të ketë shqiptuar aktgjykimin [...].

[...]

107. Në lidhje me dispozitat e lartpërmendura, Dhoma vë në dukje se parashtruesi ka ngritur para Kryetares argumentin se ajo kishte “larguar” nga Paneli i kundërshtuar i Gjykatës së Apelit një gjykatës, të cilin fillimisht e kishte caktuar të merrte vendim në lidhje me apelin e parë të ndërmjetëm të parashtruesit. Dhoma gjithashtu vë në dukje se Kryetarja e rrëzoi këtë argument, duke deklaruar se gjykatësit nuk caktohen në panele të përhershme, por caktohen në procese ose faza në bazë të nenit 33 të Ligjit vetëm kur nevojiten dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren për Caktimin (shih paragrafin 31 më lart).

108. Kryetarja në vijim konstatoi se korniza ligjore e DHS-së parashihte caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit pas paraqitjes së një apeli të ndërmjetëm dhe se caktimi përfundonte pasi paneli merrte vendim në lidhje me apelin e ndërmjetëm. Në këtë aspekt, ajo nxori përfundimin se apeli i ndërmjetëm ishte një fazë e veçantë e procesit sipas nenit 30(3) të Ligjit dhe se, për rrjedhojë, caktimi i gjykatësit përfundoi në momentin e përfundimit të procedurës që lidhej me atë fazë. (shih paragrafin 33 më lart).

109. Në lidhje me interpretimin e Ligjit nga Kryetarja, Dhoma vë në dukje se, në fakt, neni 30(3) i Ligjit parashikon caktimin e një paneli në një fazë të procesit. Nga nenet 30(3) dhe 33(1)(c) të Ligjit del se faza e apelit mund të fillojë në tre raste: (i) kur paraqitet një kërkesë/parashtresë për apel të ndërmjetëm në lidhje me ndonjë vendim të gjykatësit të procedurës paraprake ose të trupit gjykues sipas së drejtës nga neni 45(1) i Ligjit; (ii) kur miratohet leja për apel të ndërmjetëm sipas nenit 45(2) të Ligjit; ose (iii) kur paraqitet njoftimi për apelim të aktgjykimit të një trupi gjykues në përputhje me nenin 46 të Ligjit.

110. Dhoma gjykon se skenarët e lartpërmendur aktivizojnë faza të ndryshme të procedurës së apelit. Faza e apelit e procedurës e nisur specifikisht me një apel të ndërmjetëm mund të zhvillohet edhe ndërkohë që vetë çështja gjyqësore është në një fazë tjetër para një paneli tjetër, si në rastin konkret - në fazën paraprake para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Duke qenë se marrja e vendimit në lidhje me një apel të ndërmjetëm përbën një fazë të veçantë të procedurës së apelit, caktimi i gjykatësve për atë fazë, sipas nenit 30(3) të Ligjit, mbaron me përfundimin e detyrës së tyre.

111. Dhoma arrin në përfundimin se konstatimet e mësipërme nuk bien në kundërshtim me nenin 33(1)(c) të Ligjit. Në veçanti, Dhoma vë në dukje se neni 33(1)(c) i Ligjit thotë se caktimi i panelit të Gjykatës së Apelit përfundon në ditën pasi ai shqipton “aktgjykimin”. Përdorja e fjalës “aktgjykim” mund të sugjerojë që paneli

duhet të vijojë të jetë i caktuar për shqyrtimin e themelësisë së një çështjeje në shkallë të dytë. Në të njëjtën kohë, neni 33(1)(c) i Ligjit përcakton caktimin e një paneli të Gjykatës së Apelit në tre raste të ndryshme të specifikuara më lart (shih paragrafin 110 më lart). Në rast të caktimit të një paneli të apelit për të marrë vendim në lidhje me një apel të ndërmjetëm, paneli nuk do të nxjerrë një “aktgjykim”, pasi në shkallë të dytë nuk ka shqyrtim të çështjes. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh kontekstin në të cilin është përdorur fjala “aktgjykim” në nenin 33(1)(c), ajo më shumë i referohet vendimit në lidhje me apelin përkatës, qoftë ky një apel i paraqitur kundër një aktgjykimi sipas nenit 46 apo një apel i ndërmjetëm i paraqitur sipas nenit 45(1) ose (2) të Ligjit.

112. Gjithashtu, Dhoma vë në dukje se leximi i Ligjit në mënyrën e lartpërmendur ndeshet edhe në praktikën e DHS-së. Në veçanti, vendimet e ndryshme për caktimin e gjykatësve të nxjerra nga Kryetarja tregojnë se ajo ka caktuar vazhdimisht panele të veçanta të Gjykatës së Apelit, që kanë qenë shpesh të përbëra nga gjykatës të ndryshëm, për të vendosur në lidhje me apele të ndryshme të ndërmjetme në të njëjtën çështje gjyqësore. Gjithashtu, kjo praktikë kishte filluar dhe ishte konsoliduar shumë përpara se parashtuesi të parashtonte ankesën e tij para Kryetares.<sup>140</sup>

113. Në lidhje me interpretimin e Ligjit nga Kryetarja, Dhoma rikujton parimin e përgjithshëm se i takon në radhë të parë paneleve kompetente të DHS-së që të

---

<sup>140</sup> Shih, për shembull, për çështjen KSC-BC-2020-04, IA001/F0002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 30 qershor 2021 (me të cilin u caktuan gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen); IA002/F00004, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 10 nëntor 2021 (me të cilin u caktuan gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Nina Jorgensen); për çështjen KSC-BC-2020-06, IA001/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 5 shkurt 2021 (me të cilin u caktuan gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen); IA005/F00005, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 7 qershor 2021 (me të cilin u caktuan gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Kai Ambos); për çështjen KSC-BC-2020-07, IA001/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 4 nëntor 2020 (me të cilin u caktuan gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Kai Ambos); IA002/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 6 janar 2021 (me të cilin u caktuan gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen); IA005/F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 16 qershor 2021 (me të cilin u caktuan gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Nina Jorgensen).



interpretojnë dhe zbatojnë Ligjin.<sup>141</sup> Dhoma konstaton se interpretimi që Kryetarja u bën dispozitave përkatëse të Ligjit në lidhje me caktimin e panelit të kundërshtuar të Gjykatës së Apelit nuk ishte arbitraritet flagrant dhe i qartë, në një mënyrë të tillë që do të krijonte një problem sipas nenit 32(1) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës. Dhoma konstaton se ankesa e parashtruesit se Kryetarja e kishte caktuar panelin e Gjykatës së Apelit në kundërshtim me Ligjin nuk krijon perceptimin e shkeljes së nenit 31(2) të Kushtetutës ose nenit 6(1) të Konventës. Rrjedhimisht, në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së, kjo ankesë duhet të shpallet e papranueshme.

114. Së fundi, Dhoma vë në dukje se parashtruesi gjithashtu pretendoi se, me anë të caktimeve të veçanta të paneleve të ndryshme, Kryetarja kishte pushtetin për të ndikuar në marrjen e vendimeve nga gjykatësit e DHS-së të caktuar në panele të ndryshme. Parashtruesi pretendoi se caktime të tilla të paneleve eliminonin garancitë institucionale që sigurojnë pavarësinë dhe paanësinë e gjykatësve të DHS-së, në kundërshtim me nenin 6(1) të Konventës dhe nenin 31(2) të Kushtetutës. Në këtë aspekt, Dhoma vë në dukje se parashtruesi nuk faktoi këtë pretendim konkret, qoftë konkretisht në lidhje me Panelin e kundërshtuar të Gjykatës së Apelit (shih paragrafët 104 dhe 105 më lart) qoftë në lidhje me mungesën më strukturore të pavarësisë ose paanësisë së gjykatësve të DHS-së më në përgjithësi. Për rrjedhojë, Dhoma e rrëzon këtë pjesë të ankesës së parashtruesit si të pabazë, dhe, rrjedhimisht, të papranueshme në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

## VII. PËRFUNDIM

115. Bazuar në sa më lart, Dhoma rrëzon si të parakohshme, për shkak se nuk ekziston statusi i viktimës, ankesën e parë të parashtruesit lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtës së tij themelore për t'u gjykuar nga një gjykatë "e themeluar

---

<sup>141</sup> Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, KI 96/18 dhe të tjerët, cituar më lart, para. 51; KI 38/15, cituar më lart, para. 30.

me ligj”, sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës. Rrjedhimisht, kjo pjesë e Kërkesës Referuese të parashtruesit, në këtë fazë të procesit, duhet të shpallet e papranueshme në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së. Dhoma rikujton konstatimin tjetër të saj se, në këtë fazë të procesit, dhe pa cenuar vendimet e ardhshme në lidhje me kërkesat referuese, problemi nëse akuzat duhet të jenë të lidhura me pretendimet konkrete të Raportit nuk krijon perceptimin se është shkelur e drejta e parashtruesit për një “gjykatë të themeluar me ligj”, sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.

116. Dhoma konstaton se ankesa e dytë e parashtruesit, lidhur me mosdhënien e një mendimi të arsyetuar, nuk krijon perceptimin se është shkelur neni 31(2) i Kushtetutës dhe neni 6(1) i Konventës. Rrjedhimisht, kjo pjesë e Kërkesës Referuese të parashtruesit, në këtë fazë të procesit, duhet të shpallet e papranueshme në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

117. Së fundi, Dhoma konstaton se ankesa e tretë e parashtruesit, lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij themelore për t’u gjykuar nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj” nuk krijon perceptimin se është shkelur neni 31(2) i Kushtetutës dhe neni 6(1) i Konventës. Rrjedhimisht, kjo pjesë e Kërkesës Referuese të parashtruesit, në këtë fazë të procesit, duhet të shpallet e papranueshme në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

118. Dhoma rithekson se përfundimet e mësipërme janë nxjerrë duke pasur parasysh fazën aktuale të procesit dhe pa cenuar vlerësimin nga Dhoma të kërkesave të ardhshme referuese që mund të paraqesë parashtruesi.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, me vendim të njëzëshëm,

1. *i shpall* të papranueshme ankesat e z. Hashim Thaçi të ngritura në Kërkesën Referuese; dhe
2. *rrëzon* Kërkesën Referuese në tërësi.

/nënshkrimi/

**Vidar Stensland**  
**Kryegjykatës**

Hartuar në anglishte, të hënën, 13 qershor 2022  
Në Hagë, Holandë